



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Vi Saziv

Prolečno zasedanje

Komisija za ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu, industriju i regionalni razvoj

Sednica br.61/2019

Priština, od 20.3.2019, u 11:00časova

Zgrada skupštine, sala C-405

Z A P I S N I K

Prisutni : Sala Berisha Shala, predsednica, Dardan Sejdiu, prvi zamenik predsednika, Lutfi Zharku, Hykmete Bajrami, Memli Krasniqi, Veton Berisha i Duda Balje, članovi.

Odsutni: Adem Hoxha, drugi zamenik predsednika, Glauk Konjufca, Liburn Aliu, Muharrem Nitaj, članovi.

Učesnici: Arsim Janova, Selman Hoti, Izet Rushiti, Besim Sejfičaj i Petrit Pepaj, ZRRE; Berat Rukiqi, OEK; Arian Zeka i Visar Ramajli, OEA; Vëllaznim Osmani, KPK; Iliriana Hajdari, KESKO; Bujar Jupaj, KEDS; Rea Kryeziu, OEK; Trim Tërnavë, kompanija “Jaha Grup”; Adelina Bajrami, ZRRE; Naxhije Arifaj i Viktor Buzhala, KEDS; Sanie Jusufi, “Koha ditore” i Vatra Qehaja, LVV.

Pomoćno osoblje komisije: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti i Veton Raci.

Sednici predsedavala, Sala Berisha Shala, predsednica komisije.

Dnevni red :

1. Usvajanje dnevnog reda;
2. Usvajanje zapisnika sednice od 14.3.2019;
3. Diskusija, u vezi uznemiravanja biznisa o snabdevanju električnom energijom;
4. Ostalo.

Predsednica je ustanovila da su ispunjeni uslovi o početku rada komisije i otvorila je sednicu prema dnevnom redu.

1. Usvajanje dnevnog reda;

Dnevni red je usvojen bez promena.

2.Usvajanje zapisnika sednice od 14.3.2019;

Zapisnik sednice od 14.3.2019, usvojen je bez primedbi

3.Diskusija, u vezi uznemiravanja privrednika o snabdevanju sa električnom energijom;

Predsednica – obavestila je prisutne da nakon uznemiravanja nekih privrednika o snabdevanju sa električnom energijom, primila je i napisмено, zajednički zahtev is Ekonomske Komore Kosova i Američke komore. Zato, danas smo ovde, na ovoj saslušnoj sednici kako bismo dobili informacije od nadležnih institucija po ovom pitanju, kao što su Kancelarija regulatora za energiju, Ministarstvo ekonomskog razvoja, Ministarstvo trgovine i industrije, kao i udruženja privrednika i operatera, da zajednički vidimo izlaz iz ove situacije i da vidi gde su problemi.

U ime udruženja, zahteve je predstavio predsednik Ekonomske komore Kosova, g.**Berat Rukiqi**, i rekao je da u vezi sa pitanjem liberalizacije energetskeg tržišta i kada je u pitanju samo-potrošnja električne energije, EKK, OEAK i KZK smatraju da trenutna postavljena ograničenja od strane Energetskog regulatora ne podstiču ulaganja u alternativne izvore energije, a samim tim i povećanje energetske efikasnosti.

Takođe, su diskutirali i g.**Arian Zeka**, iz Američke ekonomske komore, g. **Vëllaznim Osmani**, iz Kosovskog Kluba proizvođača i **Trim Tërnav**, predstavnik kompanije “Jaha Grup”.

Dok je na postavljena pitanja, odgovorio g. **Arsim Janova**, vršilac dužnosti Kancelarije Energetskog regulatora, koji je istakao da KER, samo doneo odluke u skladu sa zakonom, gde je trebalo da kao država, uskladimo zakonodavstvo Energetske zajednice sa zakonodavstvom EU-e.

A od članova komisije, **Hykmete Bajrami**, **Memli Krasniqi** i **Dardan Sejdiu**, u svojim diskusijama, podržali su zajednicu privrednika u njihovim zahtevima i zahtevali su da obe strane sednu i donesu zajednički zaključak o zaštiti biznisa, ali naravno i očuvanju interesa građana.

Nakon diskusija, komisija je jednoglasno podržala zahteve udruženja biznisa da : KER ne želi da odloži sprovođenje odluke o otvaranju tržišta do stvaranja praktičnih okolnosti, što bi omogućilo pravilnu implementaciju odluke; KER da razmotri odluku o ograničavanju sopstvene potrošnje rešavanjem problema privrednika.

Diskusije su predstavljene u tran skriptu, deo ovog zapisnika.

4.Ostalo
Sledeća pitanja

Sednica je završena u 13:00.časova

Pripremili : Pomoćno osoblje komisije.

Predsednica komisije,

Sala BERISHA SHALA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
I MBAJTUR MË 20 MARS 2019**

**SA SEDNICE KOMISIJE ZA EKONOMSKI RAZVOJ,
ODRŽANE 20. MARTA 2019. GODINE**

**MARS - MART
2019**

Rendi i ditës

1. Shqetësimet e bizneseve për furnizim me energji elektrike

Mbledhjen e drejton kryetarja e Komisionit, Sala Berisha Shala.

KRYETARJA: Mirëdita të gjithëve!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, sigurisht është dikush këtu? S'është kurrkush!

Përfaqësues të ZRRE-së,

Odat Ekonomike, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane dhe të gjitha odat tjera, të gjithë ju të pranishëm,

Media, shoqëri civile,

Kërkoj falje që ndoshta ju ka ra me prit pak, ne pa humbur kohë do të fillojmë, ndërkohë do të na bashkëngjiten edhe kolegët tanë deputetë.

Sot kryesisht ju kemi ftuar në një formë të një seance dëgjimore të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, me një temë të rëndësishme. Kemi marrë shumë vërejtje, ankesa nga bizneset kryesisht ato, të cilat merren me prodhimin e energjisë elektrike alternative për qëllimet e bizneseve të tyre dhe domethënë është diskutimi lidhur me,

1. Shqetësimet e bizneseve për furnizim me energji elektrike

Jemi munduar si komision parlamentar që të marrim informacione nga institucionet kompetente për këtë çështje, nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, duke pas informacionet si copëza kemi vlerësuar se është më mirë të ju ftojme bashkërisht këtu në një diskutim, në një debat publik në lidhje me këto problematika. Natyrisht që ne kemi marrë përgjigjet me shkrim nga këto institucione që i përmenda, që personalisht për mua kanë qenë paksa të mangëta dhe tani e kemi mundësinë dhe rastin që bashkërisht t'i diskutojmë, mos ta marrim si një ballafaqim qëllim keq, por është qëllim i mirë në mënyrë që bashkërisht të shohim cila është rrugëdalja në qoftë se është problem, paraqesin problem ligjet që janë në fuqi apo ndonjë dispozitë e caktuar ne jemi këtu kryesisht për bërjen e ligjeve sa më të mirën në të mirën e qytetarëve të Kosovës natyrisht në të mirën edhe të bizneseve.

I njëjti shqetësim është ngrit edhe nga odat ekonomike në një mbledhje të caktuar të këtij Komisioni për Zhvillim Ekonomik, në kuadër deri institucional. Kemi marrë edhe nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe nga Oda Ekonomike Amerikane një letër që unë nuk dëshiroj me humb kohë, por do dëshiroj të ua kaloj fjalën juve, ndërkohë që do të na bashkëngjiten edhe kolegët tjerë deputetë. Nuk po e bëjmë kështu njëfarë radhe, por kush e donë fjalën? Atëherë,

faleminderit pra për këtë lehtësim, po kalojmë te odat ekonomike. Oda Ekonomike e Kosovës, zoti Rukiqi fjala është e juaja.

BERAT RUKIQI: Faleminderit kryetare!

Të nderuar deputetë,

Kolegë nga Oda Ekonomike Amerikane, Klubi i prodhuesve,

Përfaqësues të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, të KEDS-it, të mediave, siç është informuar opinioni publik në tri javët e fundit një ndër shqetësimet kryesore që është për komunitetin e biznesit, për sektorin privat, përkatësisht për pjesën më të madhe të prodhuesve në vend është çështja e furnizimit me energji elektrike.

Kur i referohem furnizimit me energji elektrike, nuk dua të hy te pjesa që është problematike tash e 19 vite, domethënë një problem që lidhet me kapacitetet tona gjeneruese, me rrjetin, me të gjitha problemet që ekzistojnë, ndërprerjet, e kosto shtesë që janë nga të gjitha këto, por te një problem specifik që i ka dy komponentë si problem. Komponenta e parë është rregullat e reja për tregun që burojnë nga ligjet e pakos së tretë për energji dhe komponenta e dytë ende lidhen me këtë ose me këtë kategori të konsumatorëve të energjisë elektrike është mundësia për vetë konsum përkatësisht pamundësia që kanë krijuar vendimet e ZRE-së për këtë kategori për shfrytëzimin e vetë konsumit si mundësi alternative e furnizimit me energji elektrike me kosto më të ulët. Te pjesa e parë që dua të ndalem është pjesa e procesit, pra ne e dimë që ZRE-ja është autoriteti vendimtar sa i përket përcaktimit të rregullave në tregun e energjisë, por në të njëjtën kohë funksioni bazë i ZRE-së është mbrojtja e konsumatorit. Konsumatorët nuk janë vetëm amvisëritë, konsumatorët më të rëndësishëm janë pjesa e bizneseve.

Unë besoj që të gjithë duhet të sigurohemi që ZRE-ja është në këtë rol, pra në rolin primar që e ka në mbrojtjen e konsumatorit, pra kjo është pjesa e parë me të cilën besoj që duhet të kemi diskutime jo vetëm tani por në vazhdimësi. Është e vërtetë që ka pas një informim në ueb faqe të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, ka pas edhe një komunikim me bizneset, mirëpo nuk ka pas një proces informativ i cili garanton që këto kompani të jenë saktë të informuara me atë se çka i pret. Ne e dimë domethënë nivelin e njohurisë së përgjithshme që ka ky vend sa i përket funksionimit të tregut të energjisë edhe vetë operatorët që janë brenda tregut energjetik kanë probleme me kuptua funksionimin e tregut të energjisë, domethënë ata që janë brenda vetë sistemit e ne nuk mund të presim që me një letër apo me një publikim në ueb faqe që këta të dinë saktësisht se çka i pret. Domethënë vërejtja e parë ka të bëjë me procesin e përgjithshëm edhe në një komunikim që e ka pas publik ZRE-ja në njëfarë forme na akuzon pjesën e odave ekonomike që ne nuk kemi qenë mjaftë aktivë në diskutime dhe në diskutime publike. Është e vërtetë që ndoshta nuk kemi qenë specifikisht aktivë, mirëpo në çdo diskutim publik besoj që ka pas komunikime edhe sidomos te pjesa e vetë konsumit ka qenë kërkesë e komunitetit të biznesit edhe ka pas diskutime publike gjatë vitit 2017 ku është reflektuar kërkesa për lejimin e vetë konsumit. Do ta shpjegoj pak më vonë këtë pjesën e vetë konsumit për me pas më të qartë se çka është kërkesa.

Ajo që është urgjente, imediate dhe shumë shqetësuese për biznese nga komunikimet e këtyre tri javëve të fundit prej që këto biznese janë kontaktua nga KESCO si furnizues i vetëm në kushtet ku ne po hapim treg dhe i kemi edhe gjashtë tjerë të licencuar, të cilët nuk mundën me operua, ZRE-ja mundet me na shpjegua pse s'mund me operua ata gjashtë të tjerë. Pra, jemi në situatën e njëjtë që kemi qenë para një viti, Ligji për këtë pako për ligjet e energjisë që nga viti 2016, me ligj nuk lejohet periudhë tranzicionale për implementim, mirëpo ZRE-ja me udhëzuesin e vetë e ka mundësuar duke e konsideruar që në treg nuk ka kushte të mjaftueshme për konkurrencë të barabartë, për hapje të tregut dhe e ka shtyrë këtë për një periudhë të caktuar dhe jemi tash. Situata e njëjtë që ka qenë atëherë kur është miratuar udhëzuesi e njëjta situatë është edhe sot, edhe pse i kemi 7 të licencuar kushte për ofrim të furnizimit me energji elektrike në tregun e Kosovës ka vetëm KESCO. KESCO në komunikimet që i ka pas me operatorët, me kompanitë që janë po them gjithmonë po i referohem që i kemi prodhuesit dhe eksportuesit më të mëdhenj të këtij vendi ju ka thënë në mënyrë shumë transparente që në kushtet këta nuk po mundën me e shit rrymën e rregullume ose me çmim të rregulluar që e marrin nga KEK-u, pra atëherë kërkohet që të furnizohet nga importi kostoja e energjisë elektrike është 30-40% më e shtrenjtë për të gjithë këto kompani, sidomos për fazën e parë për këta që e shfrytëzojnë rrymën e tensionit 35kW edhe pastaj edhe për të gjithë tjerët që e shfrytëzojnë rrymën e tensionit 10kW.

Çka nënkupton 40% për një kompani që faturën vjetore të konsumit të energjisë elektrike e ka 1 milionë euro. Janë 400 mijë euro më shumë me pagua për energji elektrike. Çka nënkupton kjo në praktikë? Janë dy zgjidhje: mbyllja e fabrikave ose zhvendosja në Maqedoni. Ta keni parasysh prej muajit qershor nëse s'gaboj kur përfundon autostrada zona industriale e Shkupit është 30 minuta prej Prishtinës, domethënë vetëm 30 minuta është faktikisht për ... për shembull, për kompaninë që është, është vetëm 10 minuta, kështu që këta nuk janë këtu për qëllime humanitare në Kosovë, nuk ekzistojnë kompanitë për qëllime humanitare, po duan me realizua një profit dhe një veprimtari të duhur e cila mundëson mirëqenie. Pra, kjo është situata me të cilën ne kanosemi nëse nuk ka ndryshim, nëse nuk ka edhe një shtyrje edhe çka nënkupton kjo shtyrje, jo vetëm shtyrje sa për sy e faqe ta kemi edhe një shtyrje, por brenda një viti të ulemi dhe të shohim pse nuk po mundemi me krijua kushte me pas më shumë operatorë apo më shumë furnizues në treg. Nëse nuk kemi shumë furnizues dhe shumë konkurrencë me çmime nën treg çka janë alternativat dhe tash po dal te alternativa. Kur është diskutuar publikisht Rregullorja që e kam këtu për procedurat e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në burimet e energjisë së ripërtitshme dhe ku parashihet vetë konsumi, fryma e diskutimit kërkesa pse ka shkuar, ka shkuar me iu mundësua këtyre konsumuesve të mëdhenj të energjisë me ul faturën e energjisë elektrike, në fund të vitit me pagua 20, 30, 40% më pak nga mundësia e këmbimit me rrymën e energjisë elektrike. Dhe pa ndonjë arsyetim të fuqishëm as ligjor, as teknik kompania e parë që ka aplikuar për këtë është një kompani e prodhimit të tjegullave, të materialit ndërtimor "Brikos" në Kamencië, në Dardanë qysh do që i referohemi, ajo kompani është refuzuar.

Sa për informim ne kemi pas një tryezë të rrumbullakët e kemi diskutuar këtë çështje edhe me ministrin e Zhvillimit Ekonomik, pastaj kemi pas një takim me kryeministrin. Kuptim të diskutimit të politikave jo të çështjeve rregullative për shkak se rregullatori në letër konsiderohet i pavarur, mirëpo çka nënkupton pavarësia e rregullatorit sipas meje, nënkupton pavarësi prej kompanive që janë në tregun energjetik dhe nënkupton pavarësi prej grupeve apo interesave politike dhe ... por rregullatori nuk mundet me qenë i pavarur prej qëllimeve zhvillimore të këtij vendi dhe rregullatori nuk mundet me qenë ose me i ik rolit primar që e ka mbrojtjes së konsumatorit. Duke siguruar që në treg ka çmime të përballueshme të energjisë elektrike, ju deputetë të nderuar e keni miratuar strategjinë e energjisë të këtij vendi dhe shtylla kryesore e kësaj strategjie është siguria energjetike dhe mundësia që konsumatorët me i përballua çmimet e energjisë elektrike, nëse ne shkojmë me këto rregullat të tregut vetëm ta sqarojmë, ne absolutisht nuk jemi kundër tregut të hapur, përkundrazi avokojmë, po nëse avokojmë për rregulla të tregut të hapur duhet me pas edhe kushte që ka treg të hapur dhe nëse nuk ka kushte atëherë çka po vijmë, në çfarë shtate po vijmë?

Këta konsumatorë mos me mujt me e përballua pagesën e energjisë elektrike ose faturën e energjisë elektrike dhe me shikua pastaj alternativa. Nëse në këtë rast Rregullatori nuk e merr parasysh këtë atëherë del jashtë rolit të vetë primar që e ka që është mbrojtja e konsumatorit edhe obligimi që me punua konform qëllimeve që i ka dhe strategjia energjetike e këtij vendi me pas çmime të përballueshme të energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët. Nëse nuk mundet kjo me u sigurua me rregulla apo me vendime të Rregullatorit, atëherë duhet me pa alternativat a është subvencionimi, tarifa industriale, një problem tjetër që kurrë nuk është diskutuar si duhet është që Kosova është vendi i vetëm ku biznesi e subvencionin edhe amvisërinë, raporti apo ajo diferenca 70 me 30. Domethënë këtë totalin e energjisë që shpenzohen në vend që e merr KEDS, KESC, KEK-u, e marrin hidrocentralet të gjithë ... domethënë të gjitha ato kostot që krijohen për me pas energji elektrike 70% e paguajnë bizneset, 30% e paguajnë amvisëritë.

Kështu që në çdo aspekt, domethënë aspekti i parë diskriminimit është ky te bizneset si konsumatorë, aspekti i dytë i diskriminimit është nëse nuk kanë mundësi me u furnizua me çmim të përballueshëm dhe aspekti i tretë është mos lejimi i vetë konsumit, këto tri çështje janë arsyeja pse ne kemi kërkuar këtë takim dhe pse kemi mobilizuar një numër të madh të institucioneve për me jep zgjidhje. Faleminderit! Ndoshta nuk isha i shkurtë, por megjithatë është çështje komplekse.

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Rukiqi! Ishe shumë i qartë. Dikush tjetër, kush e do fjalën? Po Oda Ekonomike Amerikane, zoti Arian Zeka.

ARIAN ZEKA: Faleminderit! Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal,

Të nderuar përfaqësuese, kolegë nga asociacionet e biznesit, anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, media.

Ashtu siç po mund ta vëreni edhe Oda Ekonomike Amerikane, Oda Ekonomike e Kosovës janë të bashkë rënduara me një qëndrim për sa i përket edhe klubi i prodhuesve meqenëse përfaqëson në mënyrë specifike prodhuesit për çështjen e energjisë elektrike për çështjen e energjisë elektrike, respektivisht ... pika e parë është eliminimi i kufizimeve për sa i përket vetë konsumit nuk do ta përsëris edhe që e tha edhe zoti Rukiqi më herët, por vetëm do ta plotësoj pak. Ne besojmë që rregullat momentale realisht dekurajonë investimin në energji alternative dhe krijimin e burimeve të reja të gjenerimit të energjisë elektrike nga burimet alternative gjë që besoj që është në interesin e të gjithë qytetarëve të Kosovës edhe të vendit. Sa për të krijuar një balanc për sa i përket burimeve të prodhimit të energjisë elektrike edhe natyrisht e dyta është kjo, do ta potencoj fuqishëm atë që tha edhe një herë zoti Rukiqi më herët e që është çështja e liberalizimit të tregut. Duke besuar fuqishëm që nuk ka kushte në praktikë për hapje të tregut atëherë natyrisht që Zyra e Rregullatorit të Energjisë si agjenci publike dhe e pavarur dhe që në mision të saj duhet ta ketë si element kryesor shërbimin në interesa të publikut duhet ta marrë në konsideratë këtë kërkesë tonën edhe natyrisht edhe në formën e një përgjigje që tashmë kryetari i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë e ka dhënë edhe ... takim tjetër, në të cilin ne e kemi pasë me kryeministrin e Republikës gjithherë duke e respektuar edhe pavarësinë që një institucion i tillë duhet ta ketë. Është pak paradoksale që në 2-3 vitet e fundit derisa edhe ne, edhe asociacionet e tjera të biznesit kemi folur për Rregulloren e çështjes së tarifave për konsumin e energjisë elektrike nga industrinë, më konkretisht për eliminimin e këtij ... të cilin e përmendi më herët zoti Rukiqi edhe krijimin e një çmimore të re të cilën industrinë prodhuese në Kosovë do të favorizoheshin ashtu siç janë praktika edhe në shumë shtete anëtare të Bashkimit Evropian, pra nuk është diçka e re që ne do të bënim e tashmë po flasim për një rrezik i cili u kanoset pikërisht prodhuesve për shtrenjtim të faturave të energjisë elektrike.

Prandaj, në këtë aspekt po e përmbyll këtu meqenëse me siguri edhe tjerët kanë për të thënë shumë, do të lusim edhe anëtarët e komisionit parlamentar para të cilit ndodhemi sot edhe të gjithë deputetëve të Kuvendit që të kërkojmë llogari nga ZRE-ja dhe natyrisht të kërkojmë prej tyre që të shtyjë vendimin për hapje të tregut për një vit po ndërkohë duke rishikuar zhvillimet të cilat ndodhin për sa i përket krijimit të kushteve praktike për një liberalizim të mirëfilltë. Ajo që kemi parë nëse më lejohet edhe kjo në vendet e rajonit është pikërisht edhe në shtetet fqinje të Republikës së Kosovës ka pasur iniciativë të tillë edhe në të njëjtën kohë për shkak të mosfunksionalizimit ose mos liberalizimit praktik të tregut janë marrë vendime për shtyrjen e një vendimi të tillë. Po i referohem rastit të Shqipërisë, pra edhe shumë shtete tjera të Ballkanit Perëndimor janë liberalizuar tregjet e energjisë elektrike, por situata mbetet e njëjtë, furnitorët

tradicional disa prej tyre në pronësi të shtetit ende vazhdojnë që të jenë furnitorët kryesorë të energjisë elektrike. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Zeka! Kush e do fjalën? Klubi i Prodhuesve të Kosovës, zoti...

VLLAZNIM OSMANI: Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të ZRE-së, kolegë nga asociacionet dhe Odat e Kosovës,

Pa dashur të hy shumë në detaje për këtë pjesën e problemeve që i kemi për një kohë të gjatë në aspektin e furnizimit të rregullt me energji elektrike si në kuptimin e ... të qëndrueshëm, kualitativ dhe pa ndërprerje ashtu edhe në aspektin e çmimeve, të cilat kanë qenë dhe mbeten të papërballueshme për sektorin e prodhimit në përgjithësi, por mirëpo edhe nëpër ekonomitë familjare në përgjithësi. Desha me u ndal, unë pajtohem plotësisht me ato që i përmendi zoti Rukiqi edhe zoti Zeka, ne jemi plotësisht të pajtimit me të gjitha ato aspekte, unë desha me u ndal vetëm edhe pak te kjo pjesa e kufizimeve, të cilat ZRE-ja i ka vendosë në vitin 2017 përmes Rregullores për skemën mbështetëse për gjeneratorët e burimeve të ripërtitshme të energjisë.

Këto kufizime janë jo të drejta dhe nuk janë në frymën e dhënies së mundësisë së zhvillimit të sektorit të energjisë së ripërtitshme ku faktikisht edhe ne si shtet kemi marrë edhe obligime ndaj BE-së për arritjen e kuotave të caktuara për gjenerimin e kësaj energjie, kur prodhuesit kanë filluar të inkurajohen me, po janë të inkurajuar në mënyrë vetjake të investojnë në këto mundësi të gjenerimit të energjisë faktikisht ZRE-ja me nene të ndryshme përmes Rregulloreve të ndryshme është duke e pamundësuar një investim në këtë sektorë. Kjo për neve është e pakuptimtë edhe shpresojmë ne kemi bërë edhe një kërkesë para disa muajve për ndryshimin e këtyre neneve, të cilat e pamundësojnë ose të cilët e kufizojnë nivelin e instalimeve deri në 100 kw edhe mos të ketë kufizime për sektorin e prodhimit edhe tu mundësohet këtyre të zhvillohen tutje edhe të sigurojnë energjinë për nevojat e veta. Faleminderit!

KRYETARJA: Kush e don fjalën? Përfaqësues të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, zoti Janova fjala është e juaja. Domethënë i dëgjove edhe odat ekonomike edhe Klubin e prodhuesve, i ngritën shqetësimet pothuajse të njëjta, kufizimet për gjenerim të energjisë bazuar në Rregullore, besoj po dua me besua dhe me shpresua që rregulloret dhe udhëzimet administrative ... legjislacionit sekondarë duhet të bazohet në ligj jo përtej ligjit. Të shohim tash ku janë problemet, fjala është e juaja!

ARSIM JANOVA: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar anëtarë të këtij komisioni,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të odave ekonomike, Odës Ekonomike të Kosovës, Odës Ekonomike Amerikane, pastaj Klubit prodhuesve, KESCO-së,
Të nderuar media dhe ju që këtu po e ... këtë proces,
Krejt ajo që e kuptova edhe në bazë të asaj që këtyre ditëve është aktuale në dy kërkesat e odave ekonomike, një është çështja do të thotë që është çështja e ti e kuptove që prej 2017 kemi filluar me hap tregun në bazë të ligjeve që janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës, që janë domethënë ato ligje kanë reflektuar disa nene nga pakoja e tretë e BE-së për energjinë, për hapjen e tregut, janë transpozuar disa nene atje dhe kështu që ne në një mënyrë kemi filluar hapjen e tregut në bazë të ligjit që në një mënyrë e kemi obligim edhe kompetencë nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Nuk kisha me u lëshua në kualifikimet disa se Berati nganjëherë po lëshohet përveç kërkesave që kanë lëshuar edhe në kualifikime për pavarësinë e Rregullatorit nuk ... edhe në media nganjëherë me dalë me thënë edhe anëtarët çka duhet me plotësua bordit për me u zgjedh, mirëpo kërkesat sepse duke prit edhe nga Oda Ekonomike e Kosovës që të ketë një takim me ne për shembull me shfaq çdoherë kërkesat e tyre, brenga, shqetësimet e tyre para nja 10 ditësh kanë organizuar një tryezë kështu me thënë të paorganizuar por me disa paragjykime ose me disa kualifikime paraprake, ftesa kur na ka ardhur na ka ardh sikur një akuzë që ne po e pengojmë proceset edhe të merrni pjesë në një tryezë jo të organizuar edhe pikërisht edhe për atë arsye dhe s'kemi marrë pjesë në atë takim, ne jemi shumë transparent kështu që këtë ia kam thënë edhe kryetarit të ri të Odës Ekonomike se sa kohë që është zgjedh nuk ka shpreh një gatishmëri me ardh me na pas një takim zyrtar me u njoftua që jam kryetari i Odës Ekonomike edhe unë jam për këto edhe çdoherë domethënë kontaktet i kemi për çdo brengë edhe të bizneseve. Sa i përket përkrahja e biznesit si Rregullator në kuadër të përgjegjësisve tona nuk ka dyshim që ne jemi munduar çdoherë në përkrahje, ne që tri vjet po flas unë si anëtarë që jam i Bordit të ZRE-së ne para dy vitesh 8% e kemi zbrit tarifat për bizneset, kurse vjet 5%, kurse për amvisëritë kanë mbet ato tarifa çfarë kanë qenë. Pikërisht tu dashtë me e ulë këtë diferencën mes bizneseve edhe amvisërisë, sepse bizneset në një mënyrë e ndër subvencionojnë edhe amvisëritë.

Po pikërisht hapja e tregut ne e vlerësojmë që hapja e tregut do të diktojë edhe eliminimin e këtyre diferencave, sepse vetë tregu e përcakton pastaj edhe çmimin edhe e përcakton domethënë ato në një mënyrë vjen gradualisht duke e eliminuar edhe këtë diferencë që është mes kategorive të konsumatorëve. Domethënë, bazuar në Ligjin e Rregullatorit për Energji dhe pakos së ligjeve të energjisë domethënë 2016 dhe që kanë hyrë në fuqi ne qysh meqenëse është paraparë brenda 9 muajve dhe të nxirren edhe ato aktet nënligjore ku parashihet edhe aktet dytësore domethënë për zbatimin e ligjit ne në janar të vitit 2017 e kemi nxjerrë një udhëzues për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, i parasheh tu marrë parasysh rrethanat çfarë i kemi e kemi paraparë jo menjëherë me i qit në treg, sepse ligji e parasheh të gjithë konsumatorët, të cilët i kanë mbi 50 punëtorë të punësuar dhe mbi 10 milionë realizim vjetor

duhet të dalin në treg. Mirëpo, ne pikërisht tu e pas parasysh tregun ... nuk e kemi të gatshëm për t'i hedh menjëherë në treg njëkohësisht ne kemi shkuar një herë me tension të lartë, të gjithë konsumatorët e industrisë janë të kyçur në tensionin e lartë 220 që është Feronikeli, ... menjëherë ajo ka dalë në treg, kurse në tensionin 110 që janë Trepça edhe Sharr Cemi ata prej një 1 prilli 2017 domethënë në një mënyrë i kemi qit në treg.

Për tension 35 edhe 10 ne kemi menduar që në 2018 ata në fazën e dytë, vitin e dytë t'i qesim në treg, por meqenëse një vit pothuajse s'patë bordi një kuorum për vendimmarrje ne momentin që është kompletua si bord ne morëm një vendim që ta shtyjme bile për këtë vit. Mirëpo, tu e marrë parasysh që edhe 10 edhe 35 mendonim që prapë janë shumë ne në tetor të vitit të kaluar vendosim veç 35 me i qit prej 1 prilli të këtij viti në treg kurse 10-shin me e shty për vitin 2020 se janë më shumë konsumatorë. Për 35 që po themi është fjala për 14 konsumatorë, konsumatorë kur themi janë të gjitha kompani... ka edhe publike që janë Ibër Lepenci, është ujësjellësi është edhe kompani tjera që janë domethënë që janë në tensionin e lartë. Pikërisht kërkesa e tyre është që të shtyhet për këto kompani, domethënë për këto 14 kompani edhe për një vit me arsyetimin se tregu nuk është kah funksionon. Ne si Rregullatorë përveç që e kemi nxjerr udhëzuesin e kemi bërë të gjitha përgatitjet domethënë kemi zgjedh edhe furnizuesin e mundësisë së fundit, sepse e parashih ligji atje që nëse një konsumator që e qesim në treg nuk e gjen furnizuesin ai për dy muaj ne e kthejmë e rregullojmë edhe pse me një çmim pak më të lartë është e mundësisë së fundit, por pas dy muajve sipas ligjit e kemi në dorë me e çkyç deri sa te gjen ai furnizuesin.

Domethënë, edhe për mundësinë e fundit e kam përcaktuar domethënë të gjitha çka kërkohet me ligj prej anës tonë i kemi krijuar kushtet, i kemi informuar me kohë domethënë tetor diku nëntor kemi filluar me i informua këto kompani që do të dalin në treg edhe të fillojnë gradualisht të kenë kontakte me kompanitë që merren me furnizime me energji. Është fakt që janë të licencuara diku 7 plus KESCO që është 8 kompani për furnizim, mirëpo nuk mund të presim ne që mund ato kompani të funksionojnë derisa të mos fillojnë gradualisht me i qit konsumatorët në treg, sepse kuptohet që është i vështirë procesi qitja në treg kuptohet që ka te ne rrethana që me të vërtetë e vështirësojnë pak se sado që themi që çmimet e larta janë po çmimet te na i përcakton tash në bazë edhe asaj që edhe vetë kompanitë që po tregojnë që kanë hulumtu edhe do të del çmimi më i lartë në treg se sa që është aktualisht.

Ne si Rregullator domethënë nuk ka dyshim që ne domethënë në ligj jemi të detyruar të zbatojmë ligjin, ky proces nuk është që ne kemi vendos menjëherë apriori t'i qesim të gjithë ata që ju takon me ligj, kemi filluar gradualisht e kemi shtyrë procesin, jemi në proces të një kërkesë, është kërkesë plotësisht legjitime e bizneseve se pse ata e vlerësojnë që tash për tash nuk janë të përgatitur, por edhe ne si Rregullator jemi në proces edhe pse po them nga mediat edhe që kemi pasur një takim në një forum tjetër e kanë shprehur Oda Ekonomike e Kosovës dhe Oda Ekonomike Amerikane këto kërkesa po një kërkesë zyrtare domethënë tek tash që ka

ardhur në Kuvend edhe si kopje për Zyrën e Rregullatorit për Energji, sigurisht se Odat do të na e dërgojnë edhe të drejtohen edhe me shkrim si kërkesë, që ne do ta trajtojmë me shumë seriozitet, sepse edhe ne vlerësojmë se tash çdo gjë pritet prej KEK-ut dhe furnizuesit tjerë që ta marrin prej KEK-ut dhe ta sheshin deri te konsumatorët. Po dihet që është ajo marrëveshja bazë që është rreth privatizimit të KESKO-s, që tërë energjinë sa i nevojitet KESKO-s duhet t'i ofrohet KESKO-s, pastaj tepricat e energjisë të qiten në treg, ne dihet që KEKUN gjeneratorin e kemi derregullue qysh në 2017, domethënë ne nuk e rregullojmë çmimin e tyre. ata e ofrojnë çmimin, edhe pse edhe këtu na ka sjellë të jemi të hapur një problem tash se ne këtë pjesën tjetër që e rregullojmë, e kemi derregullue, ajo vetë vendos për çmimin që ia shet KESKO-s. Atëherë, po thotë mu më keni si treg edhe unë e lë këtë çmim, sepse nevojat i kam kaq. Rritja e çmimit nga KEK-u reflekton drejtpërdrejtë në tarifa, kështu që përzierja jonë thotë ju na keni qit në treg ne ju s'keni të drejtë të na përziemi. Kështu që, i kemi ato sfida në proces që janë të ndërlidhura të gjitha në mes vete, kështu që një pjesë është e prodhimi është i derregulluar, ka ndonjë... i kemi të rregulluar konsumatorët, kështu që po hasim në probleme po janë proceset tarifore.

Kështu që, po them ne sigurisht edhe do ta marrim me shkrim kërkesën sa i përket domethënë për shtyrje edhe për një vit të qitjes në treg të kësaj kategorie të konsumatorëve. Është fjala për 35 që i plotësojnë kushtet sipas ligjit që i kanë të punësuar mbi 50 punëtorë edhe që i kanë 10 milionë.

Tash për dhjetshin e kemi shty për vitin e ardhshëm e 35 i kanë pas me 1 prill me fillu tash, po tash i kemi bo përgatitjet të gjitha për të fillua e pikërisht është në proces tash kërkesa e odave të bizneseve që të shtyhet edhe për një vit me kusht që edhe gjatë vitit me një bashkëpunim edhe më të afërt edhe me shikua mundësinë qysh ne t'i bëjmë që në një mënyrë të binden edhe konsumatorët që duehet me dalë në treg vazhdimisht, sepse ne është një rrugë që ne s'kemi detyrimisht duhet të shkojmë. Tash edhe ne ashtu jemi të vonuar në këtë proces, pikërisht për shkak të këtyre arsyetimeve që po jepen jo... mirëpo ne në fillim s'kemi mujt me shku për të të gjitha, sepse s'ka pas, furnizues jan kon vetëm dy janë HIPI edhe KESKO, më vonë ka ardh GCA e Shqipërisë mirëpo më vonë janë edhe tjerat, mirëpo me kqyr ligjërisht edhe me letra domethënë s'ka arsye në aspektin praktik tash po ka problem, sepse pikërisht çmimi që jep KEK-u për KESKO-n edhe kemi dëshmime, sado që thonë çmime të larta megjithatë janë çmime më të ulëta se sa që nëse del në treg sigurisht se do t'i kenë çmimet, sepse vet importin. Kjo është për njërën çështje, për shtyrje, nëse më lejon kryetare, tash është për... nëse muj me kalu. Domethënë këto janë dy çështje.

KRYETARJA: Po, si të doni. Atëherë, së pari faleminderit.

Ajo që është pak shqetësuese fjala është se nuk duhet të jetë pengesë mos komunikimi zyrtar në mes nesh si institucione për me i zgjedh problemet që janë në të mirën edhe të klimës së bizneseve po edhe në të mirën e qytetarëve. Në këtë drejtim ne kemi obligim si institucione

kudo që jemi ligjvënës, ligj-zbatues apo agjenci e kështu me radhe, jemi të interesuar që a u drejtua me letra zyrtari sapo ta vërejmë apo ta detektojmë ndonjë problem të reagojmë natyrisht, sepse e përmendët më herët mos komunikimin në mes odës ekonomike, që unë mendoj ndoshta një portë ose një vend i këtij komunikimi është edhe Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, që është ngritur kjo çështje në mbledhjen e fundit të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, këto shqetësimet edhe të bizneseve edhe të qytetarëve edhe se mund të harroj ky kriteri për daljen ek konsumatorëve në treg që ishin dy kritere që ti ketë mbi 50 punëtorë, numri i punëtorëve dhe qarkullimi vjetor ndonjëherë ndoshta mund të jenë edhe si ngulfatëse, e mund të ketë qarkullim vjetor më shumë, që kryejnë punë me më pak punëtorë. Kështu që edhe në këtë drejtim duhet me i pa me i analizua se si është rregulluar. Në qoftë se veç e përcakton ligji për atë ne folëm edhe me kolegen deputete. Tash sigurisht që do ta zhvillojmë këtë debat në formë interaktive më mirë se s me prit kështu krejt protokollarin me e marr fjalën me pa cilat janë mundësitë cilat janë ato pengesat tjera. në qoftë se janë pengesa ligjore apo diçka tjera, të mos i bëjmë pengesa të pakapërcyeshme këto më tepër, ndoshta është pak e vrazhdë ato pengesat burokratike me prit diçka të ngjashme.

Dëshiroj me u mirëkuptua në këtë drejtim. Në qoftë se, po, urdhëro Deputetja Hykmete Bajrami ka me pyet diçka para se me kalua në këtë pjesën tjetër që ju keni planifikua me e thënë para komisionit.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit shumë. Përsëndetje për të gjithë ju prezentë që jeni. Tani u kyça pak vonë e ndoshta edhe nuk i kam mirëkuptua komplet kërkesat e përfaqësuesve të biznesit po megjithatë po i bëj disa pyetje nga ajo që kam kuptuar për me gjet përgjigje te ajo që po dua me e kuptua.

Kemi ngritur çështje në komisionin tonë edhe më herët rreth liberalizimit të tregut të energjisë. E kemi pa që çështja e licencimit të furnizuesve është fiktive përderisa asnjë përpos KESKO-s nuk është faktikisht funksionale, domethënë zoti Janova këtu... kërkoj falje. Në qoftë se ju keni kërkuar më herët... OK. Ajo çka unë desha domethënë me dëgjua prej juve është me dëgjua kufizimet që ju i keni prej kontratës së privatizimit të distribucionit, sepse në fakt është ajo kontratë që juve po ju pengon me i funksionalizuar furnizuesit tjerë dhe këto gjëra ju duhet t'i thoni. Domethënë, mos i pranoni ndoshta akuzat të cilat nuk janë në adresë tuajën. Mua është sot tepër shqetësuese që nuk kemi përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik edhe domethënë një pjesë e asaj është kjo.

Tjetra, liberalizimi i tregut të energjisë, qëllimi i liberalizimit të tregut të secilit treg po edhe të energjisë është me shkua në të mirë të konsumatorëve. Ne tash me ardh këtu me i pas përfaqësuesit e odave, të cilët kërkojnë mos me i qit në treg, domethënë këtu diçka nuk është në rregull. Unë nuk kisha dashur që liberalizimi me tregua që ju me vendos për shembull ndërmarrjen KIVO që e paskemi përfaqësuesin këtu në treg edhe zotërisë me ia kufizua

furnizimin, në këtë rast prej KESKO-s, po me i thënë dil në treg dhe blej energji elektrike prej dikujt që është më shtrenjtë se KESKO-ja sepse duhet me u funksionalizuar operatorët tjerë. Ky liberalizim i tregut është komplet artificial.

Operatorët ekonomikë duhet me i qit në treg po duhet me ua lënë mundësinë prej kujtdo që kanë dëshirë ata me u furnizua. Domethënë, në qoftë se e ka më lirë me e ble energjinë elektrike prej KESKO-s, ai le të vazhdojë e jo me e qit në treg e me i thënë nëse kthehesh prapë në KESKO-, unë duhet me ta shitë energjinë pak më shtrenjtë, që thatë brenda dy muajsh me kërkesë mundemi me e kthye të sistemi i rregulluar, por normalisht me tarifa më të shtrenjta. Domethënë, mua po më intereson kjo, pse duhet me i shtypë do të thotë me i detyrua me dalë në treg dhe pse operatorët ekonomikë me këto kriteret që i kërkon ligji nuk e kanë mundësinë me zgjedh se prej kujt po duan me u furnizua. Domethënë, jo me e caktua në këtë rast me u thënë dilni te këta operatorët që ne i kemi për furnizim, por këta kudo që të gjejnë energjinë elektrike më lirë. Edhe ne e kemi pa që për shkak të kontratës, po mendoj e kemi diskutuar këtë gjë, për shkak të kontratës së distribuimit është obligim që KEK-u me i shitë krejt energjinë elektrike në këtë rast KEDS-it, KESKO-s, që është kompani bijë e KEDS-it dhe nëse ka teprica me iu shitë konsumatorëve tjerë.

Ne kemi pasur takime edhe me komunitetin e energjisë, që na kanë thënë që liberalizimi i tregut të energjisë në Kosovë nuk bëhet, është domethënë diçka fiktive. Ne mund t'i kemi 100 operatorë të licencuar por funksional e kemi një edhe nuk mund t'i themi që e kemi bërë liberalizimin. Tash tregonani kur ju po pritni faktikisht që me u eliminua pengesat për një liberalizim real, jo fiktiv edhe çka mund të bëjmë ne që t'u ndihmojmë operatorëve të cilët po kërkojnë me u shty kjo. Unë besoj se nuk do të duhej të jetë problem, nëse kjo është akt nënligjor, atëherë unë sinqerisht kërkoj prej Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, që derisa bizneset të kërkojnë me dalë në tregun e liberalizimit dhe me i gjetur furnitorët e tyre me ua dhënë një mundësi të tillë. mirëpo, jo me i detyruar duke i bërë ata që të blejnë energji elektrike ku është më shtrenjtë, po me i lënë me zgjedhë. Pse? më tregoni a ka pengesa ligjore që operatori ekonomik me zgjedh edhe sot edhe nesër edhe kurdo qoftë që ai të furnizohet kudo që ka dëshirë.

Mandej, kjo domethënë kuotat e burimeve të ripërtërishme është çështje me vete, e cila edhe për atë kemi marrë ankesa të ndryshme nga operatorët që janë tash në proces të prodhimit të energjisë elektrike, që në fakt nuk po mund ta plasojnë, qoftë ata që po prodhojnë për vete, tepricën që e kanë nuk po mund ta zbrazin në sistem e tjera, e tjera, domethënë plotë gjëra tjera. mirëpo, prej juve po kërkoj çka ju kufizon ligji, çka ju kufizon kontrata dhe cilat janë gjërat që po varen prej juve e nëse varen prej juve, prej akteve nënligjore, ku ju nuk keni kufizime në kontratë, atëherë urdhëroni të bëjmë diçka të mirë për komunitetin e biznesit, sepse me të vërtetë është në interes të krejt qytetarëve të Kosovës, nëse ne i ndihmojmë komunitetit të biznesit.

KRYETARJA: Faleminderit, deputete!

A po do dikush prej deputetëve me shtua apo... Urdhëro, Memli Krasniqi, deputeti.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit kryetare!

Ju përshëndes kolegë deputetë, po ashtu juve përfaqësues prej ZRE-së, odave, klubit të prodhuesve dhe KEDS-it, KESKO-s.

Më vjen keq që shumë herë na ndodh neve në Kosovë dy minuta në dymbëdhjetë me i diskutua do tema. kjo është përgjegjësi edhe e bizneseve edhe e odave që janë përfaqësues të bizneseve edhe juve si institucion rregullator në këtë rast edhe neve si deputetë edhe të gjithëve. Po dua me thënë është një traditë shumë fatkeqe, sepse ma merr mendja shumë më lehtë kishte me qenë pa presionin kohor para tre muajsh, ose gjashtë muajsh, me e diskutua këtë problem konkret.

Po realisht këtu tash nuk jemi për të ndarë fajin e as ndoshta me dhënë përgjegjësi kush është dashur me i çua letër kujt. Ndoshta faji është te ligji! Nëse faji është te ligji, atëherë përgjegjësia është e deputetëve me e ndërrua ligjin. Po flas në përgjithësi, jo veç për çështjen konkrete. Liberalizimi i tregut është absolutisht i nevojshëm. Unë jam i bindur që vetëm tregjet liberale mund ta zhvillojnë një vend edhe ta zhvillojnë një ekonomi e veçanërisht te tregu i energjisë.

Po çka mund të themi për tregun energjetik në Kosovë? A është liberalizuar? Nëse e keni liberalizuar në letra kjo s' domethënë që është liberalizuar përnjëmend. Analogjia të cilën ma kujton ky lloj liberalizimi i tregut është sikur zgjedhjet parlamentare në Jugosllavi dhe në Shqipëri në '45-ën, kur ka qenë partia komuniste dhe do parti tjera edhe kanë thënë kemi zgjedhje edhe kemi opsione edhe krejt mandatet i kanë fituar ose fronti demokratik në Shqipëri ose fronti... qysh është thirrur në Jugosllavi. E vërteta është se në Kosovë s'ka liberalizim të tregut, kështu që mos ta mashtrojmë njëri tjetrin. mua më vjen keq nëse ju jeni të obliguar, edhe pse unë absolutisht nuk po mund ta kuptoj qysh mund ta licenconi dikë që s'mund të më shesë rrymë mua. Ku është logjika? Qysh liberalizohet tregu kur ju i jepni licencë dikujt e unë po dua të blej rrymë prej tyre, pse s'mundem? Hajde, amvisëritë s'munden, po sot këto biznese edhe këta operatorë t'i quaj, e është edhe Ibër-Lepenci edhe janë disa ujësjellës, nëse duam me ble rrymë prej tjetërkujt s'mundemi. Atëherë, këtu vjen roli juaj si rregullator.

Nëse s'duan me ble te KESKO, sepse KESKO ua ka dhënë ofertën shumë më të shtrenjtë se deri tash, është e drejtë e tyre, ju ua keni dhënë të drejtën. Nuk bën me i ra në qafë KESKO-s. Nuk është fer me i ra në qafë sot KESKO-s. Ligji ua ka lejuar këtë punë, rregullatori ua ka aprovuar këtë punë. Këta kanë shkuar kanë thënë tash kqyre e kanë ata arsytimin me thënë KEK-u po na e shet rrymën shtrenjtë. Kanë probleme me tarifatat tjera, dy vjetët e fundit është vogëluar tarifa e interesit, ka mundur me pas interferim te plani i tyre biznesor edhe këta thonë tash unë kama të drejtë me ligj me shku KIBO-s, Ibër-Lepencit edhe të tjerëve me u thënë e keni rrymën 40% më shtrenjtë.

Problemi im është ky, rregullatorët edhe institucionet publike duhet me e pas qëllimin kryesor edhe të vetëm me qenë në shërbim të qytetarëve për të mundur me ua letësuar punën ose jetën edhe jo me ua vështirësua. Plus e kemi edhe një dallim, që duhet të jem i singert. Ibër-Lepenci nuk ka me u lodh për këtë farë pune. nuk mërzhiten shumë, se Ibër-Lepenci ka fonde publike, as ujësjellësi rajonal i Prishtinës e një ujësjellës tjetër, ata kanë me na e rritë edhe çmimin e ujit. Kanë me e rritë çmimin e ujit për me mujt ofset me e mbulua koston që ka me ua rritë KESKO, po çka kanë me bë bizneset private ekzistuese dhe ato që donë me ardhë. E kemi një qeveri qysh e kemi pas një qeveri para kësaj qysh e kemi pas qeverinë para saj e secilën qeveri që thotë jemi tu bo ambient për me zhvillu biznes, jemi tu bo ambient të përshtatshëm për investitorë të huaj, jemi tu bo kushte të mira për investime. Këto s'janë kushte të mira për investime, këto veç kushte të mira nuk janë. në momentin kur ty të rritet kostoja e energjisë elektrike për prodhuesit atëherë ne s'kemi çka flasim për ambient të mirë të biznesit. Unë nuk e di qysh keni me dalë te këto rangimet e raportit të bankës botërore për të bërit biznes e kështu me radhë.

Çka po dua të them është kjo, me e thjeshtua, nuk duhet të kemi obligim diçka që s'mundemi me e realizua. Gabim është nëse ia kemi dhënë vetes obligim me e liberalizua tregun nëse s'mundemi dhe nuk pajtohem me idenë që një herë duhet me u thënë bizneseve hajt dilni ju në treg e të kqyrim a po funksionalizohen këta të licencuarit. Jo zotëri, më fal, ai që do me ardh me e marrë një licencë në Kosovë me tana licencat sa kuptoj unë, kështu funksionon, kur ta merr ai licencën me qenë ai vet në treg. Nuk mund me i dhënë licencë diku me i thënë, kqyre ky shet rrymë, tash ta kqyrim t'i qesim qito bizneset e mëdhaja në treg një her. Tash, s'kanë ku me shku, duhet me shku në KESKO, këta i thonë jo i keni 40 a 30% ma shtrenjtë prej të parit, çka me bo tash këta? Me thonë eh prit veç pak, hajt po shkojmë po i thërrasim këta shtat të tjerët.

Shqetësimi im personal është ky. Po e liberalizojmë tregun, në thonjëza, e po i dëmtojmë bizneset. Pra, e tha edhe kolegja Bajrami, e thanë të gjithë në fakt. Pse po themi që kemi treg të liberalizuar. A bën të kallëzojmë drejt, që s'kemi treg të liberalizuar, kemi monopol. Dhe nuk po e shoh shumë problem unë pse kemi monopol, me thënë drejtë, në këtë moment. Jam 100% për liberalizim, por s'jam për liberalizim të rrejshëm, për mashtrim edhe në mes njëri tjetrit në kuptimin institucional legal, por edhe mashtrim publik. Nuk po dua ta fajësoj KESKON këta janë tu e kry punën e vet. qysh ua ka mundësua ligji në Kosovë, po me 1 prill kur të na thonë jo, s'kemi marrëveshje, në daçi me tarifën time të re liberale ose hiç. çka me ba bizneset me 1 prill. Cvila është zgjidhja që ua ofroni, sepse unë besoj që ju si rregullator këtë përgjegjësi duhet me e pas, sepse realisht s'është tregu i liberalizuar. A mundemi me ble rrymë në KEK, a mundemi me ble rrymë te do të Shqipërisë që i përmendët? Edhe qysh e blen rrymën? Pesëfish më shtrenjtë se sa KESKO. Përgjegjësia juaj si rregullator përveç me e rregullua tregun energjik është mos me e rregullua në mënyrë që e dëmton këtë vend, sepse atëherë është edhe përgjegjësia jonë si detpuetë që u kemi zgjedhur, ju kemi dhënë mandat. Ne ju kemi pas besuar secilit veç e veç...

Po flasim për kompanitë më të mëdha në Kosovë, këta janë prodhuesit, këta ta ndikojnë këtë ekonominë tonë të lodhtë që e kemi edhe qet raport të keq tregtar, pa këta është edhe më keq. Këta i mbajnë me siguri me mijëra njerëz në punë. Lëre që s'jemi kah e lehtësojmë punën hiq, tu i rritë rrogat në sektorin publik, po tash po ua rëndojmë edhe me energji. Unë sinqerisht jam goxha konfuz në këtë farë situatë dhe nuk mendoj që mjafton me thënë secili e kemi kryer punën. Asnjë rezervë s'e kam në kuptimin që ju e keni kryer punën e juaj si rregullator. Ligji është, strategjia është, standardet evropiane janë, pakoja kjo ligjore ajo pako ligjore... Në Evropë në 2006-tën me kartela grithëse e mbushin rrymën në amvisni. Sot e ke këtë nesër e blen atë.

Unë mendoj që e kemi përgjegjësinë e përbashkët që me i ndërru edhe ligjin, nëse është e nevojshme. Qëndrimi dhe mendimi im personal është, nuk kemi as nevojë e as zor për me e rrejt njëri tjetrin e as vetveten. S'ka treg liberal në Kosovë, s'ka kushte për treg liberal në Kosovë. kur të bëhen tre furnizues të vërtetë, atëherë mundemi me vazhdua tutje. nëse s'ka tre furnizues realë duhet me ua heq licencat edhe atyre. Më falni, po sinqerisht nuk po më duket në rregull. Tregu i energjisë janë edhe temat tjera, është dëmtu me këso licenca fiktive. Ne ia kemi dhënë krejt kapacitetet e energjisë së ripërtërishme njerëzve që kurrë as një baski s'e kanë ngulë në ato kapacitete që kanë pas me i ndërtua me vjet. Kjo s'ka të bëjë me juve, ka të bëjë me neve, me Qeverinë, me Kuvendin, sepse nuk po ju thirrjmë me e shkel ligjin, mos të keqkuptohemi as rregullat e brendshme. Çkado që mund të bëjmë ne në procedurë të përsheptuese në qoftë nevoja e bëjmë, ama nuk mundemi me e rrezikua funksionimin e bizneseve prodhuese në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, deputet! Kush e deshi fjalën? Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit!

Përfaqësuesve të ZRE-së, odave ekonomike, KEDS-it, KESKO-s që është sot këtu prezent dhe të gjithë deputetëve që jeni këtu,

Unë nuk do e zgjas shumë, sepse shumë gjëra janë thënë edhe sot prej deputetëve por edhe në të kaluarën sa i përket kësaj idesë së privatizimit të një monopoli natyror e më pastaj pasojave që vijnë prej privatizimeve të tilla. Në atë kohë, me sa mbaj mend, ka qenë ideja e sigurimit të furnizimit, eficiencë e tjera, e tjera... që për pasojë logjike në ekonomi kanë edhe uljen e çmimit. Sot jemi në situatë tjetër, rrethana tjera, e fatkeqësisht zinxhiri në sektorin e energjisë po shkon duke u privatizuar çdo ditë. Pra, nëse furnizimin dhe distribuimin sot e kemi kështu qysh e kemi, ne radhë është prodhimi dhe miniera që e furnizon atë prodhim e qe besa, ky 30%-shi është si temë aktuale sot dhe besoj se nuk duhet të ndodh pa liberalizim adekuat të tregut, ndonëse unë kam këtu pikëpyetje të madhe duke pasur parasysh qysh e keni modeluar energjinë në Kosovë, sektorin e energjisë, që mund të ndodhë ajo ndonjëherë, sidomos jo deri në 2043-tën, nëse s'gaboju, qashtu i bie ajo kontrata e Contourit me qenë.

Kështu që çmimet nuk kanë me u bë më të mira. Na çka jemi duke bërë këtu, është që me këto diskutime tu u mundu me e shty të pashmangshmen, që e kemi aprovuar si shoqëri kemi qenë në gjendje me i mbyllë sytë në situata e rrethana ku kemi ndërtuar konstrukte ekonomike në sektorin energjetik, që kanë veç një qëllim, privatizimin e fitimit dhe bartjen e kostos te aktorët në këtë shoqëri e që janë konsumatorët industrialë dhe rezidencialë. Pra, në vend se me diskutua për modelin ekonomik që na duhet e më pastaj me e organizua energjinë në kuadër të modelit dhe nevojave të shoqërisë, ne kemi ra në fetishin e privatizimit, se fetish ka qenë kjo, privatizimi u bë qëllim. Ne ia nisëm me folë për privatizimin, thuase qajo është ilaçi i kësaj shoqërie e tash duhet me u marrë me tema që janë pasojë e kësaj.

Unë i kam dy pyetje për ZRRE-në. Nuk po dua ta zgjas por po mendoj që të jemi të qartë se ku jemi.

E para, kemi privatizuar distribucion dhe furnizim, jemi duke e privatizuar prodhimin me 450 MGW me çmime që janë të paracaktuara me një raport tuajin çmimi aty na del që rritet për 50%. Pra, shpëtim nuk ka, ose shpëtim ka nëse po qysh jemi mobilizuar sot të mobilizohemi edhe kundër asaj, sepse përndryshe ky 50% ka me ju rrokë. S'ka shpëtim prej kësaj pune. S'kemi pse me ju ikë. Countour Globali ka me ua rritë çmimit secilit prej juve individualisht edhe për 20 vjetët e ardhshme çdo ditë e më shumë ka me ju bë kjo dhimbje temë e pastaj deputetët që e votojnë atë marrëveshje munden prapë me ardhë këtu e me ju kallëzu qysh u dashtë. Unë po ju them që çmimet kanë me ju rritë, ne këtë e shtyjmë deri më 1 prill, për aq sa mundemi me e shty, duke e pasur parasysh ligjet që i kemi në fuqi. Unë jam plotësisht dakord me rekomandimin e Memlit e po besoj edhe deputetja Bajrami e ka një rekomandim i cili mund të ec tutje, por e vërteta është kjo. Republika e Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës është duke e privatizuar sektorin energjetik në dobi të fitimit në qafë tonën, të KIVO-s, Dardanit e këtyre. Kështu që, ta kemi parasysh që kemi me e pagua shtrenjtë shumë edhe në rregull, nëse jemi dakord që privatizimi ynë, hajde të privatizojmë krejt çka ka me privatizua edhe pastaj çmimet i mbajmë ne.

Unë e kam një pyetje. Pse i keni hequr prej vetëkonsumit? A është e vërtetë kjo? A është e vërtetë që e drejta e vetë konsumit t'u hiqet 400 bizneseve. A është kjo çështje e vërtetë? Këtu në letër po thotë kështu. Vendimi i ZRRE-së që është aktualisht në fuqi, është që e drejta e vetëkonsumit t'u hiqet rreth 400 konsumatorëve të biznesi. Unë e kam si pyetje të na shpjegohet pak. Po veç e kam të rëndësishme ta trajtoj edhe këtë.

BERAT RUKIQI: Kjo kompani ka aplikuar diku 1000 kW i ka instaluar në kulm të energjisë solare. Dhe çka është qëllimi i kësaj kompanie? Këta e kanë bërë një analizë dhe e kanë parë që për shtatë vjet e kthejnë investimin në kulm që e bëjnë, u ka dalë mirë, edhe në fund të vitit, kur bëhen ato barazimet, për shkak se kjo rrymë këmbëhet me rrjetin, atëherë diku 25 për qind, apo

30 për qind fatura e energjisë elektrike është më e lirë, që në fakt e adreson pak edhe mundësinë që ne duhet të pajtohemi që ndër vite çmimi mund të rritet. Po tash i ke alternativat. Dhe çka i ke alternativën? Alternativën e vetme e ke të shkosh me këtë formën me eficiente, e cila sadopak e zbut këtë problemin e rritjes së kostos së energjisë elektrike. Prandaj, thash këtu problemet tash janë të ndërlidhura. Dhe është e njëjta kategori e konsumatorëve, është 10-shi dhe 35-shi. Dhe arsyetimi i ZRRE-së në këtë. Po tash nëse ia ka refuzuar këtij, të tjerët nuk janë domethënë...

DARDAN SEJDIU: Po vazhdoj me kërkesën që mbeta. Faleminderit për sqarim, Berat!

Kështu. Sa operatorë sot mund të veprojnë si furnizuese, sa? Dhe sa është problematike unë sot të hap një biznes dhe të aplikojë për furnizim? Sa mudnem unë si furnizues? Sa mund unë të çelë një shpk dhe të vij te ju të aplikoj për t'u bërë furnizues? A është problematike, a ka farë kërkesë, a duhet sjell ndonjë dokumentacion që ke marrëveshje me dikë për të blerë rrymë a najsen a? Po e banalizoj, por veç thjesht ta kuptoj se përnjëmend s'po e di ku është loja këtu, ku është ideja këtu, çka po duam të bëjmë? A po duam që çdo si të them, çdo veprim që e ndërmarrim ta kamuflojmë me idenë që po zbatojmë ligjin dhe ne si rregullator, s'po i akuzoj, veç thjesht po pyes, po e zbatojmë ligjin. Dhe e dyta, ose e fundit për mua, a ka mundësi të na e shpjegoni sipas ZRRE-së, çka nënkuptoni me liberalizim të tregut. Çka nënkuptoni me liberalizim të tregut, meqë sipas meje, liberalizimi dhe derregullimi janë dy çështje të ndryshme, po mua po më intereson liberalizimi, çfarë kushte duhet të plotësohen, që ju të thoni se kemi treg të liberalizuar. Se nëse ato kushte s'janë plotësuar, atëherë nuk mund t'i thuash dikujt dil në treg. Cili është kuptimi t'i thuash dikujt dil në treg nëse s'ka furnizues, apo unë s'po kuptoj diçka?

BERAT RUKIQI: Po e banalizoj krejt komplet. Çka kemi ne në treg? Për ta kuptuar pse s'mund këta të blejnë, se dikush duhet kuptuar pse këta s'kanë marrë ofertë prej tjetërkujt? Çfarë rryme mundesh? Prandaj. Çfarë rryme kemi mundësi të marrim në treg? Kemi mundësinë të marrim rrymën që prodhohet brenda tregut tonë, edhe rrymën që importohet. D.m.th. këto dy janë mundësitë. Çka prodhohet në Kosovë? Prodhohet prej hidrocentraleve dhe prodhohet prej KEK-ut. Çka importohet, importohet gjithçka çka mund të vijë, qoftë ato që janë emergjente, kontrata afatshkurta, qoftë kjo që importohet kontrata afatgjata që i ka në këtë rast KEDS-Co dhe pastaj e distribuon përmes KEDS-it.

Pse nuk mund të tjerët të blejnë rrymë? Pse furnizues të tjerë nuk mund të jenë konkurrentë? Për shkak se nuk mund ta blejnë rrymën e KEK-ut.

DARDAN SEJDIU: Pse nuk mund ta blejnë rrymën e KEK-ut?

BERAT RUKIQI: Sepse në kontratën e privatizimit thuhet që komplet sasia që KEK-u e prodhon ia jep KEDS-Co dhe KEDS-Co e distribuon.

DARDAN SEJDIU: Veç t kuptohemi, veç ta kuptoj edhe një send. Është edhe në kontratë që sot ne e kemi në tavolinë, është publike, është valide, e nënshkruar prej Republikës së Kosovës, që thotë 450 të tjera që prodhohen

BERAT RUKIQI: I merr një kompani New KEK, e pastaj ajo ia...

DARDAN SEJDIU: E kujt ia shet ajo? A e keni analizuar këtë pjesë?

BERAT RUKIQI: Ajo është debat tjetër. Vetëm ta sqaroj këtë pikën.

DARDAN SEJDIU: Jo është, sepse ky, më fal, veç ta përfundoj mendimin, se nuk është. Dëgjoni çka po bëjnë! Ne jemi duke vepruar në situata të cilat po na shndërrohen në faktike, pasi po kryhen marrëveshjet. Tash nëse vjen ti te Dardani, unë nuk jam deputet, në vitin 2023, po është një Dardan tjetër deputet, edhe i thua dëgjomë se unë po lypj prej teje aleancë si Odë Ekonomike e Kosovës, Odë Ekonomike Amerikan, Klubi i Prodhuesve Vendorë dhe të gjithëve juve që jeni këtu, po lypj aleancë me ju, që ju sot pesë vjet mos të vini te Sala, e cila është deputete që pesë mandate, do të jetë edhe të gjashtin, t'i thoni Salës si kryetare të Komisionit, kryetare po na rritet çmimi për 70 për qind. Sepse, unë qysh e kam parë atë marrëveshje. Këta ma kanë dhënë skenarin konservativ të kalkulimit, s'mi kanë dhënë krejt elementët aty, do kosto s'i kanë shti në kalkulim këta. Këta kanë fol veç çka kanë pa. Unë po ju them që sot ne e marrim një vendim, çka mund të bëjmë është ta shtyjmë për një vit, po pas një viti vallahi vjen 120 për qind.

BERAT RUKIQI: Pse po e kërkojmë njëvitëshin tash, edhe tash për ta shpjeguar.

DARDAN SEJDIU: Po nëse s'ka liberalizim, nëse po vjen një 450 megavatësh, nëse e kemi sektorin e energjisë komplet të monopolizuar edhe në prodhim, edhe në distribuim, edhe në furnizim, për çka jemi duke folur? Kjo telashe reale është kjo. Më falni, po unë si deputet sot këtë hall e kam. Çka bëjmë prej sotit? Se Memli e tha shumë mirë, po vijmë pesë minuta para 12-shit. Unë po ju them jo qe tri vjet para 12-shit po ju them, hajde e ndalim, edhe bëjmë diçka që ka kuptim për ty edhe të zgjerohesh

BERAT RUKIQI: Po supozoj. Për të... isha duke thënë se çka merr? Merr vetëm prej një gjeneratori, edhe prej atyre pak hidrocentraleve, edhe e shet. Këta tjerët furnizuese, nëse s'mund ta marrin këtë që prodhohet në Kosovë, ku duhet shkuar këta ta marrin këtë energji, duhet ta marrin në import. Z. Janova tha me të drejtë, e përcakton tregu. S'e ka, po e merr KESCO atë. E merr KESCO prej KEK-u edhe e shet në.

Jo, jo se me rend ke. Jo se ken disa çështje mi ngrit. Për të shpjeguar pse s'mund të marrë furnizuesi tjetër rrymë në treg, është e qartë ajo punë, se duhet ta marrë në import. Nëse e merr në import, është mesatarja e çmimit 30-40 për qind më shtrenjtë dhe ai nuk është konkurrent, nuk mund të ofrojë ofertë valide. E kjo është e para.

E dyta, te komunikimet dhe te çështjet e tjera, unë prapë po insistoj d.m.th. që nuk është kjo kërkesë për shtyrje, vetëm për ta shtyrë, po është për t'u ulur, për t'u ulur edhe me Rregullatorin, edhe me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik. Nuk mund as Ministria e Zhvillimit Ekonomik, as Ministria e Tregtisë të ikën prej përgjegjësisë. Kosova s'ka politikë industriale që mund ta adresojë edhe këtë problemin e furnizimit me energji elektrike. Kosova nuk ka politikë të eksportit, Kosova nuk ka politikë të tërheqjes së investimeve të huaja direke.

Jo, jo. Unë s'kam thënë komunist. Politikën industriale e ka BE-ja, e ka çdo vend, e ka edhe Amerika, e kanë edhe të gjithë.

KRYETARJA: Veç ta bëjmë një rend.

BERAT RUKIQI: Po dua të them është pako më e gjerë e diskutimit sesa mund ta zgjidhim sot. Por kjo kërkesa për shtyrje është për shkak që kemi për të ardhur në atë situatën dy minuta para orës 12 qysh e tha Memli, dhe pastaj për këtë blerje të kohës, të jemi aktiv, të jemi pra aktiv të ulemi të shohim solucionet. Vendet që kanë dashur të simulojnë industrinë, e kanë tarifën industriale. Askush nuk na ndalon neve ta kemi tarifën industriale, në çfarëdo varianti që hyhet në aranzhmane, qoftë me termocentrale të reja, qoftë me kapacitete të reja. Pastaj të shohim mundësinë, të shohim mundësinë edhe të subvencionimeve, të shohim mundësinë edhe shfrytëzimit të vetë konsumit dhe alternativave të tjera. Por një vit është kohë për të rregulluar këtë çështje. Nëse nuk rregullohet çështja e energjisë, edhe nëse nuk rregullohet konkurrenshmëria, aspekti i aftësisë konkurruese të këtyre që lidhet me këtë çështjen e energjisë elektrike, unë besoj.

Jo me Parlamentin ishte për çështje rregullative sot, për shkak. Prandaj po kërkojmë një vit kohë.

(Nuk dëgjohet për transkriptim)

HYKMETE BAJRAMI: Edhe duhet liberalizuar. U jep licenca operatorëve. Po ne e dimë ku është problemi. Problemi është asnjë operator s'mund të blejë energji elektrike prej KEK-un, sepse KEK-un e ka detyruar Qeveria me kontratë që t'ia shesë një operatori tjetër. Unë po mendoj që këtë çështje ta shterim kështu. Ne të kërkojmë si Komision për Zhvillim Ekonomik, të kërkojmë, jo të rekomandojmë, prej Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, që mos ta qes asnjë

operator ekonomik, i plotësoj kushtet, s'i plotësoj, me qarkullim, e me numër të punëtorëve, për pa pasur liberalizim real të tregut. D.m.th. ne nuk mund t'i themi KIVO-s edhe tjetrit Krikos-it, dil blije energjinë, bë pazar, tash negocio me KESCO-n, po s'ke me kënd tjetër. Po qysh e tha Memli, nëse janë tre po mund të dal edhe blen kush ia ofron më të lirën, a tash ne po e qesim në treg, po i themi shih deri sot e ke blerë me kaq euro kilovatin prej KESCO-s, sot po ia japim të drejtën KESCO-s që të negociojë me biznese e t'i thotë jo unë më nuk ta shes 35 euro, po dua ta shes 49 euro, ose 55 euro.

Ne e bëjmë këtë kërkesë prej Parlamentit për juve, ju tregonani a kryen punë kjo për juve. D.m.th. që ju ta anuloni atë vendimin. Kur kremi liberalizim real, tani flasim, por për gjërat që janë duke ndodhur, është mirë që t'i diskutojmë paraprakisht, se përnjëmend kur po bëhet vonë, ne kot. Unë po e di, kemi diskutuar me ZRRE-në saherë. Këta e kanë një kontratë, s'ka lidhje që i raportojnë Kuvendit. Kontrata është e nënshkruar prej institucioneve shtetërore, edhe nuk mundim. Edhe ne kot flasim, se të bën tërë ditën politika industriale. Subvencionimin prej kujt kemi ta bëjmë? Prapë kemi për ta bërë prej taksave të bizneseve, pra prapë ajo. ZRRE-ja prapë ka për t'u detyruar t'i fusë në tarifa, ose ka për t'ua hequr një pjesë të kostos, d.m.th. me u hjek bizneseve, me ua qit konsumatorëve, po në fund të fundit qytetarët këtij vendi kanë me paguar. Kështu që nuk është mungesë. D.m.th. ti me një kontratë të distribucionit e ke bërë energjinë elektrike top-barrierën. Oda Ekonomike i ka disa studime që deri më tash furnizimi me energji elektrike del top-barriera, po ZRRE-ja le të tregoj çka e pengon kontrata dhe çka mund t'i ndihmojmë ne si parlament.

KRYETARJA: Faleminderit!

Tash meqë jemi në kuadër të kësaj, po menjëherë fjalën do t'ia kaloj ZRRE-së. Veç një pyetje shtesë edhe unë e kam bazuar në këtë materialin që e kemi marrë dhe që u fol këtu. Nëse ZRRE e ka me ligj liberalizimin, atëherë kështu: a është kusht, apo është pengesë ligjore që nëse hiqen të gjitha kufizimet mbi nivelin e tensionit të energjisë elektrike, a e ndihmon kjo liberalizimin e plotë të tregut? Edhe tash, këto kufizimet mbi nivelin e tensionit të energjisë, a ua kufizon ligji? Këto. Ok!

Atëherë, edhe çështjen e shtyrjes besoj që do t'i marrim përgjigjet dhe natyrisht që unë e di që ju, po, ju sigurisht që nuk e keni vështir të operoni sepse e keni ligjin, i keni rregullat, dhe nuk besoj që nuk është dikush prej juve. Se tash nuk po merremi me emra të përveçëm, pra po merremi me institucionin?

Urdhëro z. Janova. Nëse ke mundësi të përgjigjesh në të gjitha çështjet që u ngritën këtu.

ARSIM JANOVA: Se unë desha, edhe i nderuari deputet Memli shkoi, që i ngriti disa çështje që ka qenë me interes edhe ai t'i dëgjojë disa gjëra, po shkoi. Nuk është problem.

Sa i përket çështjes, një çështje duhet të sqarohemi. D.m.th. ZRRE-ja punon në bazë të ligjit, që nesër mos të vijmë këtu para jush, të na thoni pse s'e ke zbatuar ligjin. Sepse ajo është më e rëndë, se thotë e ke pasur këtë nen, këtë nen, që unë po them para deputetëve, ai thotë se ke bërë këtë, se ke bërë atë. Pra çdo gjë është bërë në përputhje me ligjin. Bile, bile, ka pasur shmangie graduale, se ligji ka thënë menjëherë, po ne graduale, duke u munduar, duke e parë funksionalitetin e tregut te ne. Sa janë? Kompani fiktive s'janë ato. HEP-it s'mund t'i themi fiktive, nëse është një kompani furnizuese e Kroacisë, që është edhe publike atje.

Ne kemi kompani që i plotësojnë kushtet për t'u licencuar, por operimi i tyre është i vështirë këtu, pikërisht pse u përmend sepse ata tash të rregulluar janë me një çmim që sado që mendojmë se është i lartë për bizneset, edhe është i lartë sigurisht për kushtet tona, po është një çmim që e kemi rregulluar, sepse KESCO e merr energjinë prej KEK-ut. Edhe tash ata e kanë problem. Ta marrin energjinë prej KEK-ut, edhe t'ua shesin bizneseve, konsumatorëve, është problem nuk ka energji. Ata askush nuk i ndal se ata importojnë, po importi sjell çmim më të lartë, është i shtrenjtë për biznese. Edhe KESCO është, për shembull për Sharrcemin e Trepçën e Ferronikelin i furnizon, po me çmim të lirë, po jo që e merr prej KEK-ut. Ajo me një çmim që e merr e importon, ua shet atyre, që thamë ka filluar liberalizimi i tregut.

Po them që asnjë konsumator nuk e ka detyrim, d.m.th. e ka lirinë me secilin të kontaktojë, me marrë ofertat cili e ka çmimin më të lirë. Po sido qoftë, prapë llogaritet që ai çmim do të jetë më i lartë, se gati krejt energjia që vjen prej jashtë, e ka çmimin më të lartë, sepse vjen, paguajnë edhe ato taksa e çka paguajnë tatime të gjitha.

Po, d.m.th. kështu. Për të qenë më të qartë, kështu është me përkthim më të thjeshtë. Përndryshe nuk mund t'i quajmë se janë të licencuar. Se ai tha të licencuar fiktivë nuk janë, as nuk janë kompani, janë shumë kompani serioze, po operimi i tyre nuk është funksional, sepse rrethanat tona nuk po ua mundësojnë. Ashtu është.

Ajo është e qartë. Përndryshe po them, ne edhe më herët thash, edhe kërkesën e tyre, pavarësisht, çdoherë jemi, nuk është pse kanë kërkuar edhe më herët, pikërisht, po tregu çfarë është kemi shkuar me këto shtyrje, d.m.th kemi bërë dy herë shtyrje. Edhe tash, pavarësisht që s'na ka ardhur drejtpërdrejt, po ka ardhur mediale, po unë i kisha lutur që të na e bien edhe kështu si kërkesë, sepse ne ashtu kështu do ta shqyrtojmë, po ndryshe kur e kemi edhe shkresën, edhe me arsyetimet e juaja. Pikërisht këtë, këtë e bëni veç që na drejtohet drejtpërdrejt, jo veç si kopje, po që vjen drejtpërdrejt që na drejtohet, ne do ta shqyrtojmë seriozisht. Për neve është një lehtësim i madh që edhe Komisioni, fjala e Komisionit, juve deputetë të nderuar, orientimet që në një mënyrë na lehtëson edhe neve edhe për më tutje, se nesër në një mënyrë nuk na rrok askush. Mirëpo sigurisht. A përndryshe, prej ligjit, brenda, nëse vjen deri te vendimi që unë s'po prejudioj tash, po do t'i kemi parasysh shumë diskutimet edhe kërkesat, atëherë duhet të shihet brenda vitit, qysh të gjitha palët të bashkëpunojnë, çka mundemi qysh? Bile prej vitit të

ardhshëm, që me të vërtet, se liberalizimi, që hapja e tregut është një anëtare e Komitetit të Energjisë, anëtare kontraktuale, që në një mënyrë na obligojnë të ecim njëfarë rruge dhe në mënyrë që tash ligjet i kemi harmonizuar me pakon atje. Ne i kemi harmonizuar ligjet, a në tjetrën anë nuk ecim. D.m.th. e dimë që ka për të pasur vështirësi, e dimë, mirëpo duhet ta gjejmë rrugën graduale, po sigurt pa e dëmtuar as komunitetin e biznesit.

Kështu që, unë për këtë çështje po them desha veç më tepër të sqarohem që Rregullatori, krejt ajo çka kërkohet, me përkushtimin më të madh e ka kryer. Tjetër çështje është që janë pengesat që janë jashtë Rregullatorit, që ne po them nuk mundemi, nuk kemi, nuk është në autoritetin tonë, as që mund të bëjmë diçka, që e përmendëm deri tash.

HYKMETE BAJRAMI: Sa i përket kësaj çështje, kështu. Nëse ju pajtoheni, ne e kishim bërë një kërkesë si Komision për Zhvillim Ekonomi, bazuar në kërkesën e Odës Ekonomike dhe odave të tjera që janë këtu krejt prezent, që ligji ne po e dimë, krejt po pajtohem që ligji jua kërkon liberalizimin e tregut. Në anën tjetër, ne u pajtuam këtu të gjithë që ka licenca, po nuk ka furnizues të energjisë elektrike. Derisa nuk ka furnizues, nuk ka kushte me i qit operatorët në treg, edhe t'u thuhet tash ju negocioni çmimin e energjisë elektrike. Me kë ta negociojnë? Prapë me një furnizues. Ne ju kërkojmë, juve ju bëjmë kërkesë që ju ta shtyni për një periudhë të caktuar, nëse tash edhe odat pajtohen, njëvjeçare, dhe pastaj të shihet që pas një periudhe të ulemi dhe të shohim për të gjetur zgjidhej. Përndryshe, ne po e dimë, po ligji nuk mundet. Ne kemi plot ligje që i ka votuar ky Parlament edhe sot janë të pazbatueshme, janë të pazbatueshme në praktikë.

Nëse duhet, ndoshta duhet të kthehemi edhe të ndryshojmë ligjin, edhe të themi ne po e bëjmë liberalizimin. Po është kërkesë e komunitetit të energjisë, po ne jemi anëtarë, po komuniteti i energjisë nuk është duke e pranuar këtë liberalizim. Ata, d.m.th. ne kemi pasur takim para një muaji me Janez Kopaçën edhe ai thotë që nuk ka liberalizim në Kosovë, sepse keni të licencuar, por nuk keni furnizues. D.m.th. në kuptimin real, nuk ka furnizues sepse tregu është i papërshtatshëm. Nuk mund t'u themi kompanive dilni blini energji elektrike në treg më shtrenjtë sesa po e furnizon KESCO. Këta kishin dalë të blejnë vetëm në qoftë se ju ofrohet më lirë. Për më shtrenjtë askush nuk del të negociojë.

Mandej për çështjen e kyçjes, rasti i Krikos-it edhe operatorëve të tjerë, kjo e vetëkonsumit a çka qenka. Këtë çështje presim ndoshta ta diskutojmë.

Në qoftë se kryetare pajtoheni, ne u çojmë me shkrim. Ne sot s'kemi as kuorum të votojmë. E përgatisim me shkrim kërkesën, mund të pajtohem me odat me juve edhe mandej e bëjmë një kërkesë. A ju mjafton juve kërkesa jonë për ta shtyrë? Tash, ok.

KRYETARJA: Ju dërgojmë në letër sapo të kemi mundësinë e kuorunit. Rregullat e Komisionit janë ashtu. Nuk është problem, por nëse paraqet problem karshi obligimeve tona, se ne si shtet jemi anëtar të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Ju analizojeni, sepse jeni direkt në këtë sektor edhe bashkërisht kemi obligim që mos ta lëmë njëri-tjetrin të lajthitë në atë drejtim, të dalë diçka tjetër që pastaj të marrim edhe vërejtje.

Besoj që kjo çështja e parë u shterr. Tani vetëkonsumi. Në qoftë se s'ka dikush të shtojë diçka. A pate të shtosh diçka, a për të dytën? Ok.

Urdhëro kush e do fjalën për vetëkonsumin. Po, Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

ARSIM JANOVA: Shprehi edhe atë kërkesën e tyre dhe me arsyeshmëri. Sa i përket vetëkonsumit, në 2017-ën e kemi nxjerrë rregullën për skemën mbështetëse për gjeneratorët dhe burimet e ripërtritshme. Pra, e kemi plotësuar këtë rregull me një kapitull që parasheh edhe vetëkonsumin. Sa për informimin tuaj, vetëkonsumi është kur një konsumator ndërton një gjenerator, p.sh. po e marrim solare, për nevoja të veta, por në momentin kur ka teprica, prodhon teprica, ajo ia dërgon KESCO-s, KESCO e merr edhe KESCO pastaj atë energji ia kthen kur ka nevojë konsumatori, e kam fjalën nëse është fjala për një kompani. Po gjenerator, po.

Ne duke u bazuar edhe në këtë çështje, pavarësisht që për ne ka qenë diçka e re, për herë të parë që aplikohet, edhe pse në rajon thuajse këtu as në Maqedoni, as Mali i Zi, as Serbia, as Bosnja, as Kroacia nuk e aplikojnë këtë për vetëkonsum.

Ne gjatë përgatitjes së kësaj rregulle, janë marrë edhe konsulenca duke marrë parasysh edhe një raport i përgatitur nga konsulenca që financohen nga USAID-i. Janë marrë edhe praktikrat në Evropë që përveç Italisë që e ka të pakufizuar, edhe një shtet tjetër që e ka 200 kilovatë, të tjerat gati të gjitha e kanë 100 e më poshtë.

Në një mënyrë ne një rregull që e kemi nxjerrë, ai kapitull thotë që kanë të drejtë për vetëkonsum të kryçen konsumatorët në tensionin e ulët, tensioni i ulët merret që është 0-4 kilovolt, edhe për gjeneratorë të vegjël, që me definicionin tonë, gjeneratorë të vegjël janë deri 100 kW.

Tash kërkesat e biznesit se ka ardhur, këtë e ka aktualizuar. Ne e kemi ratifikuar. Po? Po se i kompletton disa dokumente paraprake, edhe vjen te ne. Ne e jepim, marrim vendim për më tutje, sepse edhe qitja në rrjet e energjisë që e prodhojnë të tjerët, mund të ketë edhe në sistemin energjetik, d.m.th. që mund të vjen deri te imbalancet etj. Pikërisht kjo është bërë një studim bukur i madh. Çdo rregull që e miratojmë, lëshohet në diskutim publik, pra kyçen të gjitha ato. Ndoshta ndonjëherë, pak e dëgjova kryetarin e Odës që kemi thënë nuk kanë qenë fort aktiv në

këtë aspekt kur është nxjerrë kjo rregull. Ndoshta është dashur të jenë më insistues, edhe me pa mundësinë që kërkojnë.

Kur ka ardhur në pyetje kërkesa që u përmend këtu KRIKOS-it, një kompani që ka kërkuar për 1 MW kyçje, një kërkesë ka ardhur, se ne i kemi aprovuar edhe katër kërkesa të tjera që janë prej 100 kW e më poshtë, po kjo ka ardhur me një kërkesë prej 1 MW që është shumë e lartë. Ne duke u bazuar në rregullin që e kemi, ne e kemi refuzuar. Nuk e kemi refuzuar që kemi dashur, por që na e thotë rregulli. Edhe pikërisht, tash refuzimit të kësaj kërkesë, disa ka ngjallur kërkesa të biznesit se qysh të na pengojnë.

Ne, askush nuk e pengon askënd të ndërtojë gjeneratorë për nevoja të veta pa e futur në rrjet, pra ne nuk i pengojmë. Secili është për nevoja të tij. Po futja në rrjet e tepricave ka implikime në sistem. Ne nëse e lejojmë e sasi më të madhe verës për shembull, atëherë gjenerimi është shumë i madh verës se solare po e marrim shembull. Edhe ata duhet t'ia japin KESCO-s se nuk kanë nevojë më shumë, edhe në një mënyrë ia huazojnë KESCO-s. KESCO detyrohet t'ia kthejë ndoshta muajve të dimrit. Muajve të dimrit është një energji shumë më e shtrenjtë. KESCO duhet t'ua kthejë atë energji sasi për sasi, edhe sasi për sasi atëherë çmimi është më i lartë, ai duhet ta blejë me çmim shumë më të lartë KESCO për t'ia kthyer energjinë që ia ka marrë konsumatorit të atij gjeneratori për vetëkonsum.

Edhe këto, tash ne pavarësisht kësaj, ne qysh para dhjetë ditësh, kemi marrë, Bordi janë pajtuar që ta rishikojmë këtë rregull. Të gjejmë modalitetet, ndoshta krejt jo edhe qysh kërkojnë edhe bizneset, se këta e këqyrin veç anën e vet, se çka është plotësisht normale, po ne e shikojmë edhe anën e ndikimit në sistem, se ajo energji po del në një rrugë ku për të paguhet. Nesër nuk guxojmë ne në asnjë mënyrë të paguajmë diçka prej tarifave të konsumatorëve, se prej tarifave paguajmë që janë ato caqe që i ka përcaktuar Ministria, që janë tarifa nxitëse për të gjitha burimet e ripërtritshme, për erë, e për ujë e të gjitha ato, janë të veçanta. Vetëkonsumi pra është për nevoja të veta.

Ne do të shikojmë, do të bashkëpunojmë edhe me bizneset tash kur ta bëjmë, kur ty hyjmë në këtë rregullore që. Do ta kemi gjatë diskutimit publik, po edhe kështu jemi të hapur t'i pranojmë çdoherë, të na kontaktojnë edhe para diskutimit publik, nuk është problem për atë punë, po ne duhet t'i kqyrim modalitetet që edhe nëse e rrisim kapacitetin, të kenë të drejtë të kyçen në tension më të lartë të biznesit, po duke e ruajtur çdoherë sistemin. Sistemin duhet ruajtur, sepse ne nuk jemi shumë përvojë e mirë, por pikërisht duke i marrë disa praktika në Evropë qysh janë, neve na kanë detyruar që s'guxojmë të marrim ne hapa, se nesër do të ketë shumë operatorë që duan të ndërtojnë si për vetëkonsum edhe ta lëshojnë në rrjet, edhe në rrjet nëse verës kur më së paku bëhet është konsumi i energjisë edhe detyrohet KESCO ta marrë atë energji, çka do të bëjë me atë energji. Sepse nëse e lëmë në rregull, që ajo është e pakufizuar vijmë deri te ajo. Mirëpo po them që do të përpiqemi të gjejmë modalitetin më të mirë që në një mënyrë të jenë të

kënaqur edhe bizneset, po në një mënyrë edhe ta ruajmë sistemin energjetik. Kjo është pika pak a shumë qysh e kemi ne rregull, qysh janë kërkesat e bizneseve, që ne kemi marrë vendim edhe kjo është në proces që të hyjë në rishikim, edhe nga ekspertët tanë, po nuk do të mungoj edhe po them edhe komunikimi me bizneset, se nganjëherë edhe bizneset unë i kuptoj plotësisht çfarë rrethanat janë se çfarë rrethana i kanë, se unë ndonjëherë i dëgjoj debatet shumë, i dëgjoj edhe klubet, thonë ZRRE-ja nuk shkon nga ajo p.sh. të promovojë sa më shumë me solare, ku ZRRE nuk i përcakton politikat, është Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Ne vetëm i zbatojmë politikat që i përcakton caqet, qoftë me tarifatat nxitëse, qoftë, ne jemi zbatues, jo përcaktuesi i politikave zhvillimore të burimeve.

Ne në kuadër të asaj. Për vetëkonsum po them jemi ë parët në rajon që kemi mbërri edhe me këto kapacitete deri në 100 kW. I përmenda shtetet përreth që asnjëra s'kanë qenë as Maqedonia, as Mali i Zi, s'e kanë as Serbia as shumë shtete. Pikërisht se, tash unë arsyet s'i di pse s'kanë hyrë atje, mirëpo po them ne në këtë aspekt do të kemi mirëkuptim, do të...

KRYETARJA: Faleminderit. Merruni vesh. Klubi i Prodhuesve? Po, urdhëro.

VLLAZNIM OSMANI: Shumë shkurt! Jo, vetëm, unë e dëgjova me vëmendje zotërinë prej ZRRE-së.

Unë vetëm diçka nuk po kuptoj, interesat e kujt është duke i mbrojtur ZRRE-ja? Nuk ka asnjë kuptim. Shiko, nenet e ndryshme në rregulloren që e keni bërë, keni mundur që ta lëshoni ndonjë gabim teknik ndoshta. Po, nuk ka asnjë arsye ekonomike që një prodhues të instalojë sot panele solare deri në 100 KW.

Ato mund të jenë të rëndësishme për ekonomitë familjare, ndërkaq për biznes nuk ka asnjë sens ekonomik. Domethënë në momentin që e kufizon deri në 100 KW, nuk e di cili ekspert ua ka dhënë mendimin se mund të funksionojë në gjë e tillë. Ne kur dalim publikisht me diçka, domethënë analizohen gjërat goxha mirë. Nuk kemi tendencë që ta akuzojmë askënd. Ju më herët thatë se jeni të hapur. Ne e kemi dorëzuar një kërkesë që 1 muaj e gjysmë dhe nuk jeni të qasshëm zotëri. Nuk kemi asnjë përgjigje. Kemi dashur të vijmë, të ulemi dhe të diskutojmë me juve, nuk kemi përgjigje.

Ne jemi duke folur për interesin e zhvillimit ekonomik të këtij vendi, andaj mua më intereson sesi analizoni gjërat dhe çfarë interesi mbroni. Aq!

KRYETARJA: Kisha dëshiruar që të mos shndërrohet në personale. Të kemi kujdes.

BERAT RUKIQI: Për çështjen e konsumit. Për koincidencë kanë qëlluar në të njëjtën kohë, diskutimi i vet-konsumit edhe i hapjes së tregut. Këto janë të lidhura. Pse janë të lidhura? Janë

të lidhura me koston e përballeshme për furnizim me energji elektrike. Pra, a është kosto e përballeshme për bizneset, kjo që implikon dalja në treg dhe në të njëjtën kohë, a ka mundësi ose a ka alternativa në këtë moment?

Disa prej kompanive që pak a shumë janë më të avancuara edhe që i shohin alternativat, i kanë bërë këto analiza. Dhe ka dalë që vet-konsumi që është lejuar, është mirë që është lejuar dhe është mirë që mos krahasohet me vendet tjera. Pse mos të krahasohet me vendet tjera? Sepse secili vend i ka specifikat. Nëse nuk i ka Maqedonia dhe Serbia nuk do të thotë që mos kemi edhe ne. Ne nuk mund të jemi gjithmonë përcjellës të Maqedonisë e të Serbisë, pastaj Malit të Zi, Greqisë dhe të tjerëve. Ne duhet të shikojmë se çfarë kemi këtu. Po, shumë mirë. Prandaj po e them, që është mirë që jemi të avancuar.

Nuk është argument i mjaftueshëm ngase dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik më tha që të tjerët nuk e kanë, ndërkaq ne e kemi. Meqë ata nuk e kanë ata, a do të na dalë neve mirë apo jo.

Nuk domethënë që duhet të krahasohemi me të tjerët që të shohim nëse na del mirë ose jo. Edhe shumë që kemi avancuar. Kur është avancuar në këtë drejtim, është duartrokitur atëherë nga të gjithë për faktin se është miratuar kjo.

Fryma e diskutimeve, edhe në diskutime publike, se disa anëtarë të ZRRE-së nuk e di nëse kanë qenë në atë kohë apo nuk kanë qenë, por megjithatë ka qenë një pjesë e mirë edhe e bizneseve. Fryma ka qenë, ky vet-konsum ët ndikojë në një objektiv të vetme; uljen e faturës që e paguan biznesi në fond. Pse ka ardhur deri te kjo? Për shkak se është parë potenciali që brenda kësaj që kemi ne si rrjet, të ketë mundësi të vet-konsumit.

A ka disbalancë ose a mund të ketë disbalancë? A kemi probleme me caqet indikativë që i përcakton MZHE-ja? A kemi probleme me sistemin? Edhe mund të kemi, por si bëhen politikat në vende që duan...Po i kthehem asaj se a po duam që ta përkrahim sektorin privat apo jo. Bëhet një kost benefit. A ke më shumë kosto nëse e mbron sistemin apo ke më shumë kosto nëse e dëmton sektorin privat, i humb vendet e punës. Si duhet të vendoset. Do të thotë, a është objektiv të mbrohet sistemi? A është objektiv që të kemi vende punë më shumë në këtë vend. Cila është?

Këtu unë pajtohem që këtu duhet të gjendet një balancë, mirëpo qasja në vendimmarrje nuk duhet të jetë, pra objektiv i këtij vendi nuk është që mbrohet sistemi i energjisë elektrike. Cili është objektiv i këtij vendi? Që të krijohen vende pune.

ARSIM JANOVA: Kryetare më fal! Mbrojtja e sistemit është edhe mbrojtja e konsumatorëve. S'do të paguaj askush për diçka...

KRYETARJA: A e përfundove?

BERAT RUKIQI: Nuk e përfundova. Nuk mund të vendosim asisoj. Kështu duhet të jetë logjika normale e vendimmarrjes. Pra, të jetë në balancë. Unë pajtohem se duhet të balancohet mes mbrojtjes së sistemit dhe asaj që të krijohen vende pune, po megjithatë në këtë balancë duhet të merret vendim dhe të krijohen kufizime. Në rastin e kompanisë në fjalë është krijuar kufizimi. Në gjuhën e rregullores nuk njihen këto terma, as tensioni i ultë dhe as tensioni i lartë. Nuk e përdorë ZRRE-ja këtë terminologji. Hyni dhe lexojeni rregulloren dhe askund nuk përmendet tensioni i ulët dhe tensioni i lartë. Lexojeni, gjejeni në gjuhën tuaj.

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Rukiqi! Kisha kërkuar që të mos personalizohet kjo çështje.

BERAT RUKIQI: Nuk e personalizova. Nuk iu referova askujt me emër.

KRYETARJA: Ishte një përgjigje në pyetjen; pse ndër 100 KW mund të ndodh licencimi dhe pse jo, që ishte një kërkesë mbi 100 KW. Përgjigjja ishte se Ministria e Zhvillimit Ekonomik i bën politikat.

Do tua jap fjalën juve pasi ta përfundoj unë.

Është mirë që këtu të dihet qartë, se u përmend se s'mund t'i ikë përgjegjësisë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Po, në këtë rast po kuptohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik e cila i bën politikat në sektorin energjisë. Cilat janë përgjegjësitë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, sepse unë e kam marr një letër prej ministrit të Tregtisë dhe Industrisë edhe pak a shumë një letër e përgjithësuar që as vet s'kam mundur ta kuptoj, dihet sa i përket zgjidhjes së këtyre problemeve dhe adresimin e disa kompanive për problemet që i kanë që të kyçen në rrjet kompanitë që prodhojnë energji alternative e kështu me radhë. Sigurisht se do të flasim edhe më tutje.

Para se ta kalojë fjalën në përgjigjet nga Zyra e Rregullatorit do të kisha dashur që ta dëgjoj kompaninë 'Jaha Grup'. Shqetësimet e tyre. T'u kisha lutur që të përmbahesh dhe pa etiketime personale të tregosh se cili është problemi i juaj dhe çka mund të zgjidhim ne në këtë drejtim bashkërisht me të gjitha këto institucione që jemi këtu. Urdhëroni, 'Jaha Grup'. Që të jemi të qartë, këtu incizohet komplet ky debat dhe nuk ka proces që nxirret dhe i komenton dikush. Këtu është duke u incizuar komplet ky debat dhe fjalë për fjalë e gjitha ajo që e kemi thënë do të dal pastaj me shkrim. faleminderit!

Nuk po dëshiroj që të marrë kahe tjetër ky debat. Urdhëro, 'Jaha Grup'.

TRIM TERNAVA: Meqë vij nga sektori i biznesit, po provoj të jem shumë praktik. Jam Trim Ternava drejtor i Zyrës së projekteve në ‘Jaha Solar-Jaha Grup’.

Jemi fabrika e parë për prodhimin e paneleve solare në Kosovë dhe në momentin kur është hapur fabrika kemi qenë të parët edhe në rajon. Gjëja e parë që e kemi para se të fillojmë që të operojmë në Kosovë, ka qenë analiza e legjislacionit në fuqi. Tërë kohën kemi qenë në diskutim të vazhdueshëm me Zyrën e Rregullatorit dhe organet e tjera kompetente, përfshirë edhe USAID-in, programin RIPOWER dhe të tjerat. E gjithë kjo është bërë që të shohim se çka po ndodh në Kosovë dhe cilat janë potencialet tona në Kosovë.

Ne kemi qenë pjesë e diskutimeve kur është bërë rregulla për vet-konsum. E po ashtu pjesë e diskutimeve kanë qenë edhe personat të cilët kanë punuar në atë rregull dhe sot nuk janë pjesë e ZRRE-së.

Unë e them me bindje të plotë dhe dikush nga Bordi i ZRRE-së apo kushdo që është prezent mund të ma thotë të kundërtën. Rasti i ‘Brikosit’ ka treguar që as ZRRE-ja nuk e ditur që ka kufizim 10 apo 35 KW edhe këtë e them me bindje të plotë.

Me datën 8 tetor, ne jemi ankuar në ZRRE, sepse nga KEDS-i kemi marr pëlqim vetëm për 500 KW. Domethënë ne e kemi pasur një pëlqim paraprak nga KEDS-i për kyçje të 500 KW. Jemi ankuar në ZRRE, se pse është lëshuar për 500 dhe jo 1000 MGW. Tërë kohën nga ZRRE-ja është thënë se a ka problem teknik të kyçjes në rrjet për këtë punë. Derisa kemi pritur 3 muaj e gjysmë dhe tërë kohën kemi qenë në takime me persona të caktuar në ZRRE dhe tërë kohën është thënë që vetëm jemi duke shikuar dhe shumë shpejte besojmë që nëse teknikisht është në rregull do të merrni aprovimin... Po, për 500 kemi pasur pëlqim nga KEDS-i. Ne i jemi drejtuar ZRRE-së, se pse pëlqimi është lëshuar për 500 KW dhe jo 1000 KW. Më 19 shkurt 2019...’Brikosa’ ka bërë...Jo ne në emër të tyre ngase e kemi autorizimin. Jo, jo autorizimin e kam në emër të klientit që ta përfaqësojë pranë ZRRE-së.

Jo, jo shiko, ne jemi të autorizuar nga kompania ‘Brikos’ që t’i përfaqësojmë në ZRRE. Më 19 shkurt të vitit 2019 kemi marrë refuzim nga ZRRE-ja, ku thotë që këtij klientit nuk i lejohe fare që instalojë panele solare. Nuk është problemi më 100 KW. Nuk është më problemi i kapacitetit. Praktikisht munden me qenë dy konsumatorë ngjitur njëri me tjetrin dhe njëri mund t’i instalojë 50KW dhe tjetri nuk mund ta instalojë asnjë. Kufizimi në kapacitet është diçka tjetër e diskutojmë më tutje. Kufizimi në nivel të tensionit, edhe ju e dini që nuk qëndron. Ka dalë lëshim, nëse dikush teknikisht mund ta shpjegojë se pse dy fqinjëve ngjitur; njërit i lejohe t’i instalojë 50KW pse është shtëpiak, ndërsa një fabrikës për 50KW nuk i lejohe t’i instalojë asnjë KW, unë ju kërkoj falje publikisht.

Nuk po flasim për kapacitet, t'i dallojmë pak. Çka po ndodh tash? Tash po ndodh, klientët në 10 KW edhe në 35 KW po dalin në treg të lirë, edhe e dyta po ju pamundësohet që të kenë masa që ta zbusin faturën e energjisë elektrike. Për kostot dhe për të gjitha të tjerat të instalimeve të shumta jemi të hapur që t'i diskutojmë edhe ta gjejmë një mes. Ajo është diçka krejt tjetër. Të flasim për të paren, mos të ikim nga para. Nëse dikush këtu në sallë mund të ma shpjegojë pse dy fqinjëve ngjitur dikush mund t'i instalojë 50 dhe dikush tjetre nuk mund t'i instalojë 50 KW.

Një fabrikë si 'Fortesa' për shembull, unë kam rastin konkret ngase kam bërë studimin e fizibilitetit. 'Fortesës' i lejohet ta instalojë, 'Albi Mall-it' nuk i lejohet me hy në rrjet. Ose 'Viva-s' nuk i lejohet, ndërkaq fqinjit të saj ngjitur i lejohet. Niveli i tensionit, mos të kalojmë te kapaciteti. A ka sqarim teknik se pse është lejuar? Nëse është lëshim në rregull. Ne e kemi parë që ka mbetur në rregull. A do duhej të bëhej e gjithë kjo zhurmë, të modifikohet një gabim.

A e konsideroni gabim ju kufizimin në nivel të tensionit? Në kapacitet, po flasim në pikën e dytë. Po flasim për nivel të tensionit, nëse mund të jesh konkret pa emocione. Nuk kam emocione në këtë fazë.

ARSIM JANOVA: Kryetare, nëse mundem! Sa i përket rregullës që tha Berati. Në rregull është e qartë edhe unë po e lexoj këtë nenin.

Neni 20, aplikimi i gjeneratorëve për vet-konsum dhe procedura e kyçjes; çdo konsumator i energjisë elektrike i kyçur në tensionin e ulët, e di mirë se cili është tensioni i ulët 04, të rrjetit të shpërndarjes mund të aplikojë tek furnizuesi i tij për marrjen e statusit të konsumatorit prodhues. Domethënë, kjo është e qartë.

Mos të krijojmë para komisionit diçka që nuk është...Pikërisht ajo...Unë thash se kjo është diçka e re për neve. I kemi katër operator të cilët i kemi lejuar me tension të ulët që i kanë më pak se 100 KW gjeneratorët e tyre. Pse e kemi shtyrë 3 muaj e gjysmë sepse ka qenë një kërkesë e parë që në një mënyrë kemi tentuar që t'ju ndihmojmë edhe këtë e di ky. Jemi përpjekur që ta gjejmë diku një paragraf diçka që t'i ndihmojmë që të kalojë. Pikërisht për atë edhe është shtyrë.

Arsyen pse është refuzuar e ke në vendim. Edhe paragrafin i keni të gjitha se a është gabim apo nuk është. Nuk mund të thua, sikur të thuash është një ligj gabim. Nuk është ajo punë gabim se kjo nxjerr nga bordi.

BERAT RUKIQI: Dy konsumatorë fqinj...

ARSIM JANOVA: Dy se ti i kyçur diku edhe ai tjetri diku tjetër, është e qartë. Ti je në 10 ai është në 04. Qarta janë. Dihet tensioni, ju pse po pyetni pse, ju e dini shumë mirë pse.

BERAT RUKIQI: Teknikisht...

ARSIM JANOVA: Teknikisht apo si të duash merre. Ju thatë se tensioni dhe gjithçka është e qartë. Sa i përket kërkesës së klubit, që thash na e kanë dërguar kërkesën. Pikërisht pse ka ardhur kërkesa e juaj më 21.2.2019, para një muaji, gati po bëhet një muaj, edhe kërkesa e Odës Ekonomike Gjermane që ka ardhur më 08.3, duke e përfshirë edhe kërkesën e tyre përmes paraqitjeve publike të Odës Ekonomike dhe Odës Amerikane, ne e kemi filluar rishikimin, rishqyrtim të rregullave.

Ne nuk mundemi për kërkesa të dikujt ta ndryshojmë ligjin edhe të thuhet se nuk më thirri ose nuk ma kthej përgjigjen. Është çështje e rregullave. Ne jemi duke punuar... Është dashur një trajtim, ne do ta shtimë në rishqyrtim. Pa një trajtim dhe pa një analizë... Edhe të inicohet nuk është edhe shumë e lehtë, hajt veç po vendosim.

Kështu që ajo nuk është... Tek para një jave kemi vendos për ta rishikuar. Për sa punojmë, ne e dimë sesa punohet aty përkundër stafit të vogël që e kemi. Mirëpo nuk është aty, ndoshta është mirë... Ne kemi menduar që t'i kyçim... Është i informuar që e kemi kthyer në shikim. Nuk e di a ke qenë në takimin e fundit. Në një mënyrë ju kemi informuar që e kemi në rishikim këtë rregull edhe e kam vlerësuar që duhet t'ju dërgojmë njoftime me shkrim për diçka që kemi filluar.

Nuk është problem për atë punë. Edhe pse kërkesat i kemi disa afate brenda së cilës kohë edhe do t'ia kthejmë, ngase nuk është bërë një muaj ende. Nesër i bën një muaj. Kështu që unë isha i qartë, duke e pasur mirëkuptimin për të gjitha. E kemi futur në rishqyrtim. Do t'i shikojmë modalitete më të mira bashkërisht. Por, të jo thuhet se: Është bërë gabim ose nuk është bërë gabim sepse çdo gjë është sjellë pas një procedure, një shqyrtimi, një konsultimi publik megjithatë.

Tash po e shohim, po thonë bizneset se nuk e kemi ditur se ne e kishim kthyer atëherë në diskutim publik më shumë. Kështu që nuk është problem. Ne nuk po i lëmë fajtor as bizneset dhe askënd, por janë disa rregulla që janë në fuqi. Janë disa procedura që duhet të respektohen.

Është një bord kolektiv dhe nuk është një organ i cili do të mund të vendoste vet.

KRYETARJA: Faleminderit e kuptuam! Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami, shumë shkurt.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit shumë!

Me të vërtetë jam në përkrahje qind për qind të kërkesave të bizneseve. Por, një gjë që po dua ta bëj të qartë këtu është që, Zyra e Rregullatorit të Energjisë është rregullator.

Ligjet bëhen nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, edhe strategjia për energji dhe aprovohen në Kuvend. Pra, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, duhet ta kuptoni që obligohet që t'i zbatojë të tillat. Politikat industriale, politikat tjera i bën Qeveria. Nuk është domethënë. Edhe masat stimuluese edhe të gjitha. Ky pak më shumë mua më ngjau si një diskutim, ndoshta edhe ka ndodhur, në Këshillin Kombëtar Ekonomik, por është dashur të ndodhë edhe aty. Ne e morëm se Dardani më herët e tha; 100 e disa vet-konsumues janë hequr prej rrjetit. Domethënë, faktikisht ajo nuk qenka. Qenka keqkuptim. Po me vjen mirë që kjo rregullore qenka në shqyrtim edhe unë zoti Janova po kërkoj që ju t'i ftoni odat ekonomike gjatë shqyrtimit dhe t'i merrni parasysh kërkesat e tyre. Por, nëse ka mundësi që të na ftoni edhe neve, besoj që kush ka kohë i bashkëngjitet diskutimit.

Në anën tjetër, unë po e kuptoj këtë procesin e vet-konsumit. Domethënë ne duhet ta dimë, ndoshta operatorët e dinë, unë nuk jam eksperte e energjisë, por prej asaj që kemi mësuar gjatë këtij viti në këtë komision, ne duhet ta bëjmë dallimin mes operatorit që prodhon energji elektrike dhe operatorit i cili prodhon energji për vet-konsum.

Ndryshe, nuk mundet dikush të prodhojë, për shembull ta zëmë 1 MGW dhe tash të thuhet se unë dua 800 KW t'i qes në treg, sepse është e vërtetë që ajo krijon disbalancë në rrjet edhe këta duhet ta kenë parasysh. Domethënë, solarja që u tha prodhohet gjatë verës edhe mandej operatori të kërkojë që t'ia bëjë kompensimin gjatë ditës. Edhe ju e dini sepse jeni ekspertë të kësaj. Domethënë ZRRE-në e kufizon dikush sesa mund të pranojë energji elektrike. Tash nëse doni të prodhoni mbi 1 MGW, ndoshta është mirë që të licencoheni në ZRRE dhe institucione të tjera që të merret ajo kuota që po. Përndryshe, këta konsumatorët, operatorët ekonomik që prodhojnë energji elektrike për konsumin e tyre, është mirë që këta të kenë masa stimuluese, por jo t'ju teprojë tash më shumë se gjysma e energjisë dhe të hedhet në rrjet, po me qenë një tepriçë e moderuar në mënyrë që në këtë rast të përballojë edhe rrjetin.

Ndoshta këta i dinë më mirë edhe ato disbalancat që sigurisht mund të shkaktojnë dëme. Po, unë prapë po e them që nuk i di të dhënat dhe nuk jam eksperte e energjisë, po vetëm nga diskutimet.

Tash le t'i mbetet ZRRE-së që t'i marrë parasysh kërkesat tuaja aq sa ka mundësi. Faleminderit!

MEMLI KRASNIQI: Në fakt ai zotëria atje e bëri një pyetje. Unë nuk i marr vesh këto gjëra shumë po nuk na dha përgjigje zoti Janova. Ajo pse munden të jenë dy fqinj e të kenë lidhje të ndryshme. Unë nuk e kuptova. Mbase ju e keni shpjeguar po unë nuk e kam marrë vesh.

Kjo ishte irelevante, vetëm nëse nuk përton që të përgjigjesh.

Unë po e di që jemi në fund dhe desha t'i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit, pavarësisht që mund të kenë qëndrime të caktuara të ndryshme, unë mendoj që duhet të pajtohemi për disa interesa të përgjithshme. Nuk ma merr mendja që ka ndonjë njeri në këtë sallë që me dëshirë mendon në çfarëdo forme të kontribuojë për një vështirësim të ambientit për biznes apo cilido biznes në Kosovë. Unë në fillim të fjalës sime e thashë; nuk është çështja këtu që të kërkohet fajtori. Nuk ka fajtor. Ndoshta fajtorë jemi ne deputetët që kemi miratuar ligje të cilat kanë qenë ndoshta të parakohshme. Nuk po them si konstatim, po si supozim.

Ju e keni kryer punën tuaj, odat e kryejnë punën e vet. KESCO është duke e kryer punën e vet. Bizneset tash i kanë dertet e veta. Ju thash në fillim se ndoshta është dashur para gjashtë muajsh ta ngritin alarmin edhe të përpiqeshim ta gjejmë një zgjidhje, por tradita jona është dy minuta para dymbëdhjetës.

Ju kisha lutur që në mbledhjen e ardhshme që e keni në fund të muajit si ZRRE, ta merrni parasysht seriozisht kërkesën sepse do ta keni edhe një letër mbështetëse prej komisionit. Meqenëse po flasim vetëm për 14 shfrytëzues apo konsumatorë, unë po shpresoj që nuk do të jetë shumë problematike, por shpresoj që nuk i prish shumë punë as KESCO-s, që nuk besoj që është pjesë e rëndësishme e biznesit të tyre.

Sidoqoftë, ju kisha lutur dhe ju kisha ftuar edhe si anëtar i këtij komisioni që mos të harrojmë tani që deri më 1 mars të viti të ardhshëm, por të të takohemi më shpesh edhe takohuni edhe ju ndërmjet vete ndopak. Mos të vjen puna që vetëm ne t'ju mbledhim. Takohuni edhe ju ndërmjet vete.

Ju thatë që s'po vijnë odat tek ne. Ky i kubit po thotë se kemi kërkuar takim dhe nuk po na presin. Ndoshta s'ka nevojë të ndërmjetësojë i gjithë komisioni.

Sidoqoftë, nganjëherë nuk është mirë të shikohet rendi se kush është më i madh ose kush është në hierarki ose kush është më i rëndësishëm. Ndonjëherë kur është interesi i përbashkët duhet secili ndopak ta prishë protokollin nëse është nevoja, dhe të mundohet që të kontribuojë për një interes të përbashkët, por normalisht nëse duhet dhe jo vetëm nëse duhet, por është edhe punë e jona si komisionin do të jemi në dispozicion në mënyrë që ta gjejmë në zgjidhje më të mirë pa e dëmtuar askënd. Mundemi ose jo është çështje tjetër po të paktën do të mundohemi. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, deputet! A e deshe fjalën? Në rregull, urdhëro.

ARSIM JANOVA: Fqinji e ka të drejtën se këtu e kufizon në tension ku është i kyçur konsumatori. Fqinji është në 04 që ne e kemi me rregull. Këta duan në 10 që s'mund të kyçet sepse nuk e lejon rregullorja. Aty është dallimi.

KRYETARJA: Desha ta shtroj një pyetje; në qoftë se nuk e lejon rregullorja, teknikisht a është e mundshme? Nëse është e mundshme, atëherë mund të ndryshohet rregullorja, është shumë lehtë.

(Nuk dëgjohet për transkriptim)

ARSIM JANOVA: Aty duhet të ketë kujdes që të mos ketë reperkusione edhe për konsumatorët e tjerë. Çdo kosto shtesë që shkaktohet për shkak të asaj në rrjet apo kudo qoftë, duhet të paguajmë unë edhe ai tjetri e të tjerët për vet-konsumin e atij. Kjo është, aty duhet të kemi shumë kujdes, që edhe t’ju lejohet, por pa i prekur konsumatorët e tjerë.

Ndryshe, boll po preken konsumatorët tjerë me tarifa nxitëse të cilat e kanë një çmim shumë më të lartë. Ky është sensi ku duhet...Mirëpo bashkërisht do t’i gjejmë modalitetet më të mira dhe të jenë të kënaqura edhe bizneset, por edhe do të ruajmë edhe sistemin edhe konsumatorët. Pa një sistem të fortë energjetik nuk do të ketë, që tha Berati jo sistemi po interesi. Nuk do të kesh as biznese nëse nuk e ke një sistem të qëndrueshëm energjetik.

KRYETARJA: Faleminderit! Nëse s’ka dikush të shtojë diçka...Urdhëro, Oda Ekonomike e Kosovës, zoti Rukiqi, edhe jemi kah fundi i këtij debati.

BERAT RUKIQI: Si përfundime. Besoj që janë tri çështje me rëndësi që edhe ne po i përkrahim si rekomandime. E para që të shtyhet me kushtin që të ulemi edhe të gjejmë zgjidhje të qëndrueshme. T’ia parashtrojmë vetës pyetjen se pse nuk kemi treg funksional. Dhe nëse nuk kemi treg funksional cilat janë alternativat.

E dyta, që të shikohet mundësia e vet-konsumit përderisa nuk ka probleme teknike që të realizohet. Gjithmonë duke e marrë parasysh interesin ekonomik po edhe qëndrueshmërinë e sistemit. Nëse ka çështje që lidhen me disbalancën dhe me kosto të tjera, të shohim se a mund t’i mbulojë dikush tjetër kostot dhe jo konsumatori. Ka pasur vullnet që Qeveria t’i paguaj, sidomos këtë pjesën që lidhet me verën.

E treta çështje që është shumë me rëndësi është që, jo vetëm Parlamenti, por edhe Qeveria të ketë debat të vazhdueshëm, për shkak se siç e tha krejt në fillim deputetja Bajrami, në çdo analizë të çdo ode, e sidomos një që e përcjellim ne çdo vit, ndër tri barrierat është furnizimi me energji elektrike. Nuk është vetëm çështja e rregullsisë së furnizimit, është kostoja, problemet, ndërprerjet, tensioni, lidhjet, kyçjet, infrastruktura e vjetër, pra të gjitha këto janë çështje të caktuara.

Prandaj, besoj që këto tri çështje do t'i përfshinë letra jonë që do t'i dërgohet komisionit dhe pastaj një letër e përbashkët i dërgohet edhe Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, po edhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe të tjerëve që janë përgjegjës për politikën e industrisë dhe të energjisë dhe të zhvillimit ekonomik.

KRYETARJA: Faleminderit! Kjo do të ishte një lehtësim edhe për neve si komision, në qoftë se e përmblihdni krejt këtë diskutim që e bëmë sot.

Unë nuk e di, ndoshta më ka ikur dhe nuk kam mundur ta dëgjoj, po nuk e mora përgjigjen, se nëse hiqen kufizimet mbi nivelin e tensionit të energjisë elektrike, a i ndihmon kjo liberalizimit të tregut. Ngase ne e kemi obligim që ta liberalizojmë tregun në Kosovë.

Nuk e mora këtë përgjigje. S'e di ndoshta më ikë, nuk e dëgjova mirë.

Ajo që u lidh me ligjet edhe që e kemi obligim primar ne si deputetë. Ligjet e sektorit të energjisë, zakonisht vijnë pako ligjore dhe besoj dhe mendoj që ato kalojnë nëpër disa filtrash e sidomos në filtrat që e kemi obligim që t'i përafrojmë ose në përputhje me standardet evropiane.

Sigurisht që kur të na vijnë edhe që priten me qenë në këtë vit pjesë e shqyrtimit, bashkërisht do të jemi aty gjatë shqyrtimit të këtyre draftligjeve dhe t'i ndryshojmë në qoftë se ligjet nuk i bien përshtati ambientit në Kosovë. Ne jemi këtu për t'i ndryshuar dhe për t'i plotësuar.

Atëherë, nëse s'ka dikush të shtojë diçka rreth kësaj. A ka edhe dikush diçka, ndonjë përgjigje apo diçka tjetër? Pata dëshirë ta di se a i ndihmon kjo heqja e kufizimit të tensionit, a i ndihmon liberalizimit.

ARSIM JANOVA: Për aq sa di të jap përgjigje unë, mendoj që nuk ka të bëjë me procesin e liberalizimit. Nuk ka të bëjë fare asgjë.

KRYETARJA: Faleminderit! Ju falënderoj shumë të gjithë juve që ishit sot këtu në këtë debat. Ne e kemi për obligim që të bashkëpunojmë mes vete si institucione.

Mirupafshim në takimet tjera! Jeni të lirë.

Kërkoj nga deputetët që të qëndrojnë dy minuta pasi që të largohen pjesëmarrësit.

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë